FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.138 7 tetor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJK nr.41, datë 28.9.2011	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.00-2010-837 (655), datë 18.6.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi)..	6221
Vendim i GJK nr.42, datë 29.9.2011	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr.847, datë 24.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, të vendimit nr.00-2010-881, datë 14.7.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	6224
Vendim i GJK nr.44, datë 7.10.2011	Me objekt konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të zotit Ilir Beqja.....	6231

VENDIM
Nr.41, datë 28.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Vitore Tusha	Anëtare	e “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“

me sekretare Enina Mullaj, në datë 6.7.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.28 Akti, që i përket:

KËRKUES: Abdyl Loci, përfaqësuar nga avokati Kujtim Capo, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.00-2010-837 (655), datë 18.6.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1/2, 131/f, 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi atë në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr.26, datë 27.3.2008, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës së kërkuesit Abdyl Loci. Anulimin e vendimit për mosfillimin e çështjes penale të datës 17.12.2007, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe rifillimin e ndjekjes penale për kallëzimin e bërë nga shtetasi Abdyl Loci”.

2. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.76, datë 10.10.2008, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.26, datë 27.3.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë duke vendosur rrëzimin e ankimit të ankuesit Abdyl Loci me objekt: Anulimin e vendimit datë 17.12.2007 “Për mosfillimin e procedimit penal”.

3. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër ka ushtruar rekurs kërkuesi Abdyl Loci.

4. Me vendimin nr.00-2010-837 (655), datë 18.6.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, për arsye se ai nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, sipas nenit 435/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

5. ***Kërkuesi Abdyl Loci*** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-837 (655), datë 18.6.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në Dhomë Këshillimi, duke pretenduar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën kushtetuese të aksesit në gjykatë, pra të drejtën për gjykim, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

II

A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë

6. Kërkuesi pretendon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit për arsye se nuk përmbante nënshkrimin e mbrojtësit, i ka cenuar të drejtën për t’iu drejtuar asaj gjykate dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura prej tij në rekurs.

7. Gjykata i vlerëson pretendimet e kërkuesit në kuptim të standardeve që përkufizojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Ajo është shprehur, në jurisprudencën e saj, se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga elementet më të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.14, datë 3.6.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011*). Në këtë këndvështrim, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës përbën një garanci për administrimin e mirë të drejtësisë prandaj, çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e këtyre dispozitave (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.6.2009; nr.10, datë 29.3.2011; nr.26, datë 13.6.2011)*.

8. Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta për t'iu drejtuar një gjykate nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve (veçanërisht lidhur me kushtet e pranimit të një apelimi), por këto kufizime nuk duhet të jenë të tilla sa të dëmtojnë vetë thelbin e të drejtës. Ato duhet të ndjekin një qëllim legjitim dhe mjetet e përdorura duhet të jenë përpjesëtimore me qëllimin që kërkohet të arrihet *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.30, datë 17.6.2010; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.3.2011)*.

9. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, mospranimi i një kërkese në Gjykatën e Lartë nuk duhet të cenojë thelbin e të drejtës së ankimuesit për t'iu drejtuar gjykatës *(shih vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Société Anonyme Sotiris dhe Nikos Koutras Attee kundër Greqisë, datë 16.11.2001; Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës, datë 19.12.1997; Saez Maeso kundër Spanjës, datë 9.11.2004)*. Edhe në çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë*, të datës 29 korrik 2008, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kjo e drejtë është thelbësore në një shoqëri demokratike, për shkak të pasojave që ka mbi interesat legjitime të individit.

10. Në vijim të garancive të ofruara nga Kushtetuta, neni 31/ç i saj parashikon se gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; ndërsa neni 43 i Kushtetutës parashikon: *"Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe."*

11. Gjykata është shprehur se përdorimi i mjetit procedural, të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP), nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Shqyrtimi i mjetit procedural në mënyrë josubstanciale cenon të drejtën e aksesit në Gjykatën e *Lartë (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 24.7.2006)*.

12. Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedura e gjykimit që zhvillohet në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ka si veçori paraqitjen vetëm të shkaqeve të parashikuara në ligjet procedurale (shkelje të ligjit material ose procedural). Kompleksiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë, konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.5, datë 4.3.2008; nr.10, datë 29.3.2011)*.

13. Rekursi është akti procedural në të cilin parashtrohen shkaqet për të cilat kundërshtohet një vendim, sipas kërkesave të nenit 432 të KPP-së që mundëson të drejtën e të pandehurit për të filluar gjykimin në Gjykatën e Lartë dhe, në këtë kuptim, ai është akti me të cilin garantohet e drejta për akses në këtë gjykatë. Kërkesa kushtetuese dhe procedurale, për të garantuar mbrojtjen efektive dhe profesionale të të pandehurit në Gjykatën e Lartë, ka kuptim, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë të pandehurit për të ushtruar të drejtat që parashikon procedura penale *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.38, datë 30.12.2010; nr.10, datë 29.3.2011;, nr.26, datë 13.6.2011)*.

14. Gjykata ka vlerësuar se neni 435/2 i KPP-së, i cili parashikon *inter alia* se akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen nga mbrojtësit, me pasojë mospranimin, nuk mund të interpretohet nga Gjykata e Lartë në një mënyrë të tillë që cenon thelbin e të drejtës së një individi për t'iu drejtuar asaj gjykate. Neni 435/2 i KPP-së ka për qëllim të garantojë mbrojtjen me avokat të të pandehurit, në rastin

kur ai ushtron rekurs. Zbatimi i nenit 435/2 të KPP-së, për të garantuar të drejtën e një individi për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë, duhet parë në raport me rregullimet e përgjithshme që disiplinojnë paraqitjen e ankimit (nenet 407- 421 të KPP-së), si dhe ato të veçanta për paraqitjen e rekursit (nenet 431-435 të KPP-së). Në situatën në të cilën kërkuesi ka ushtruar rekursin, në përmbushje të detyrimeve të tij formale që përcaktohen kryesisht në nenet 410, 412, 420, 435/1 të KPP-së dhe rekursi nuk është nënshkruar nga mbrojtësi i zgjedhur prej tij, ai nuk mund të privohet nga e drejta që rekursi i tij të vlerësohet sipas përcaktimeve të nenit 432 të KPP-së *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 29.3.2011; nr.26, datë 13.6.2011)*.

15. Në këtë vështrim, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, para se të vendosë mospranimin e rekursit për shkak të mosnënshkrimit të tij nga mbrojtësi, duhet të verifikojë nëse sekretaria gjyqësore ka zbatuar detyrimin ligjor për vënien në dijeni të të pandehurit, për të plotësuar rekursin me nënshkrimin nga mbrojtësi, sipas kuptimit që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.5, datë 15.9.2009, i kanë dhënë nenit 415/2 të KPP-së, duke u shprehur se "Sekretaritë e gjykatave, ku depozitohet ankimi, mund dhe duhet të vënë në dijeni të pandehurit në rastet kur rekursi paraqitet i panënshkruar nga mbrojtësi, me qëllim që, në zbatim të kërkesave të nenit 415/2 të KPP-së, ai të ketë mundësinë për plotësimin e tij". Këto kërkesa ligjore kanë rëndësi kushtetuese, sepse garantojnë realisht të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.10, datë 29.3.2011; nr.26, datë 13.6.2011)*.

16. Gjykata ka theksuar se çdo interpretim i ndryshëm, që mund t'i bëhet përmbajtjes së nenit 435/2 të KPP-së, nuk i shërben garantimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. Referimi i bërë nga Kolegji Penal vetëm në kërkesat e nenit 435/2 të KPP-së, duke mos marrë në konsideratë kërkesat e nenit 432 të KPP-së për shqyrtimin e rekursit, cenon të drejtën e individit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.8, datë 16.3.2011)*.

17. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi Abdyl Loci ka depozituar brenda afatit ligjor, pranë sekretarisë së gjykatës që ka dhënë vendimin, një rekurs i cili nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi i tij. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit për shkak se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, sipas kërkesave të nenit 435/2 të KPP-së.

18. Për sa më sipër, Gjykata çmon se, në vështrim të garantimit të standardit të aksesit në gjykatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka interpretuar nenin 435/2 të KPP-së në mënyrë të ngushtë dhe të shkëputur nga fryma e Kushtetutës dhe fjalia vijuese e kësaj dispozite procedurale. Nga materialet e paraqitura para Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë vlerësuar veprimet e sekretarisë gjyqësore përkatëse për vënien në dijeni të kërkuesit për mosplotësimin e kërkesës formale të nënshkrimit e rekursit nga mbrojtësi, në mënyrë që ai të mund të bënte plotësimet e nevojshme.

19. Përfundimisht, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi), duke vendosur mospranimin e shqyrtimit të rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se nuk ka qenë i nënshkruar nga mbrojtësi, i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë , si një nga standardet për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-837 (655), datë 18.6.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (Dhomë Këshillimi) dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në këtë gjykatë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Xhezair Zaganjori.

VENDIM
Nr.42, datë 29.9.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i “	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i “	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i “	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i “	“
Admir Thanza	Anëtar	i “	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e “	“
Sokol Berberi	Anëtar	i “	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 12.4.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.5 Akti që i përket:

KËRKUES: Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga Abaz Deda, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, në mungesë.

Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mungesë.

Ismail Nelaj, përfaqësuar nga avokat Alban Mësonjësi, me prokurë.

Fortuz Nelaj, përfaqësuar nga avokat Bashkim Merkaj, me prokurë.

Fetanete Murataj, në mungesë.

Xhevdet Nelaj, në mungesë.

Lumturi Nelaj, në mungesë.

Eva Nelaj, në mungesë.

Ender Nelaj, në mungesë.

Arben Nelaj, në mungesë.

Fiorentina Nelaj, në mungesë.

Marjeta Nelaj, në mungesë.

Sirmade Beqo, në mungesë.

Rasim Nelaj, në mungesë.

Agron Mehmeti, në mungesë.

Seit Mehmeti, në mungesë.

Pëllumb Mehmeti, në mungesë.

Engjëllushe Gruçka (Mehmeti), në mungesë.

Skënder Mehmeti, në mungesë.

Teuta Mehmeti, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.847, datë 24.6.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i vendimit nr.00-2010-881, datë 14.7.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/f, 134/g, 42, 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara të cilët u shprehën për rrëzimin e saj dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.3337, datë 27.6.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur vërtetimi i faktit juridik i qenies pronar të Rasim Nelaj të një trualli prej 80 000m^2 (8 hektarë) dhe 3000 m^2 të ndodhur në Rrugën e Kavajës, Tiranë.

2. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranës (KKKP), me vendimin nr.19 datë 30.3.2001, pasi ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga trashëgimtarët ligjorë të Qazim Nelajt, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga këta trashëgimtarë, ka vendosur që prona e tyre të kthehet dhe kompensohet si vijon:

- 1/a Një sipërfaqe trualli prej 10 000 m^2, pjesërisht e lirë dhe pjesërisht me objekte të kaluara në likuidite; në bazë të nenit 19 të ligjit 7698, datë 15.4.1993, i kthehet pronarit Qazim Nelaj (trashëgimtarëve të tij) pronësia mbi këtë truall.

- 1/b Një sipërfaqe trualli prej 8300 m^2 pjesërisht e lirë dhe pjesërisht me objekte të kaluara në likuiditet; në bazë të nenit 5 të ligjit 7698, datë 15.4.1993, i kthehet pronarit Qazim Nelaj (trashëgimtarëve të tij) pronësia mbi këtë truall.

- 1/c Një sipërfaqe prej 11 325 m^2; në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, të kompensohet pronari në një nga mënyrat që përcakton ky nen.

Prona figuron e regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.3041 datë 4.7.1997.

3. Vendimi i mësipërm i KKKP-së është kundërshtuar nga Ministria e Drejtësisë me kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si një vendim i dhënë në kundërshtim me ligjin nr.7698 datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.760 datë 27.2.2002, ka vendosur pranimin e padisë së ngritur nga Ministria e Drejtësisë dhe ka anuluar pjesërisht vendimin e mësipërm të KKKP-së për truallin prej 16 900 m^2, duke u kompensuar ish-pronari.

Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.672 datë 5.6.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.854, datë 8.5.2003, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese, me kërkesën e subjekteve të interesuar me vendimin nr.37 datë 22.12.2003, ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve të mësipërme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.9257 datë 28.12.2007 ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe anulimin e vendimit të KKKP-së.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.847, datë 24.6.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit dhe rrëzimin e padisë së Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.881, datë 14.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala paditëse, Ministria e Drejtësisë, pasi ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

4. Kërkuesi parashtron para Gjykatës Kushtetuese se Gjykata e Apelit Tiranë, në dhënien e vendimit nr.847 datë 24.6.2009, si dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, kanë lejuar shkelje të rënda procedurale që kanë cenuar parimin e procesit të rregullt ligjor, pasi:

- Gjykata e Apelit të Tiranës nuk e ka njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në seancë në përputhje me nenin 79/a të KPC-së. Kjo Gjykatë nuk ka zbatuar kërkesat e vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.13. datë 24.3.2004 që i referohet nenit 1 të ligjit nr.8551 datë 17.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", të ndryshuar.

- Gjykata e Apelit, në vendimin e saj nr.847 datë 24.6.2009, nuk e legjitimon Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e padisë, duke mbajtur kështu qëndrim të kundërt me atë të mbajtur nga të gjitha gjykatat në gjykimet e mëparshme.

- Në datën 22.6.2009, Gjykata e Apelit ka vendosur të pranojë një akt ekspertimi të bërë nga një ekspert topograf dhe të paraqitur privatisht nga avokati i palës së paditur. Gjykata ka miratuar kërkesën e palës së paditur për pranimin e aktit të ekspertimit dhe trajtimin e tij si provë, duke mos i dhënë mundësi palëve të shprehen dhe të njihen me këtë akt ekspertimi.

- Gjykata ka cenuar dhe parimin e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, pasi vetë me iniciativën e saj, shtyn seancën, pa kërkesë të palëve në proces. Gjykata, përpara riçeljes së hetimit gjyqësor, duhet t'i kishte kërkuar palëve paraqitjen e provave të tjera, nëse ata i dispononin dhe, pasi palët të ishin shprehur në lidhje me këtë pyetje të gjykatës, ajo mund të shpallte vendim për riçelje të hetimit gjyqësor, nëse palët do të kishin prova të reja për të paraqitur në proces. Gjykata, në vendimin e riçeljes së pjesshme të hetimit gjyqësor, duhet të kishte arsyetuar shkaqet për riçeljen e tij, si dhe t'i caktonte palëve detyrat konkrete që do të shërbenin për zgjidhjen e drejtë dhe të bazuar në ligj të çështjes.

- Nga ana e Avokaturës së Shtetit është ushtruar e drejta e rekursit brenda afatit ligjor, i cili është depozituar në datë 22.7.2009 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit, duke shqyrtuar vetëm rekursin e Ministrisë së Drejtësisë e duke shkelur dispozitat e KPC-së.

5. Subjektet e interesuara, në mënyrë të përmbledhur kanë parashtruar këto prapësime:

- Avokatura e Përgjithshme e Shtetit nuk legjitimohet në paraqitjen e kësaj kërkese, pasi nuk është subjekt i ligjit nr.7698 datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave*" i ndryshuar*. Avokatura e Përgjithshme e Shtetit nuk mund të ngrejë padi ndaj KKKP-së, si person juridik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

- Gjykata e Apelit të Tiranës nuk ka pasur detyrim që të njoftojë Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit, e cila në bazë të nenit 4 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999, nuk mund të përfaqësojë dhe as të këshillojë për çështje gjyqësore të një organi qendror të administratës publike kundër një organi vendor dhe anasjelltas. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është person juridik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

- Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Apelit, duke mos e legjitimuar Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e padisë, ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të mbajtur nga të gjitha gjykatat në gjykimet e mëparshme, është i pambështetur në dispozitat e ligjit procedural dhe material. Fakti se Gjykata e Apelit ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga gjykata më e ulët nuk nënkupton se ka një standard të dyfishtë. Gjykata më e lartë mund të korrigjojë gabimet e gjykatave më të ulta.

- Pretendimi se Gjykata e Apelit ka miratuar kërkesën e palës së paditur për pranimin e aktit të ekspertimit dhe trajtimin e tij si provë, duke mos i dhënë mundësi palëve të shprehen dhe të njihen me këtë akt ekspertimi, nuk mund të bëhet objekt i gjykimit kushtetues sepse vlerësimi i provave, i fakteve dhe i rrethanave të ndryshme janë atribute të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

- Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë njoftim për të gjitha palët ndërgjyqëse sipas mënyrave të përcaktuara në KPC. Paditësi, Ministria e Drejtësisë dhe të padituri, familja Nelaj, kanë marrë dijeni me shpallje dhe janë paraqitur në gjykim, kurse Avokatura e Shtetit nuk është paraqitur edhe pse ka pasur dijeni që do të zhvillohej procesi gjyqësor. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së tij për proces të rregullt nga Gjykata e Lartë është i pambështetur. Dhoma e Këshillimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka shqyrtuar pretendimet sipas rekursit dhe ka vendosur moskalimin në seancë gjyqësore. Në këtë fazë nuk njoftohet asnjë nga palët.

II

A. Për legjitimimin e kërkuesit

6. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se, në respekt të rregullimeve të parashikuara nga nenet 16, 131, shkronja "f" dhe 134, shkronja "g" të Kushtetutës, një subjekt që legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj gjykate nuk kushtëzohet nga karakteri i tij si person juridik, publik a privat, por nga natyra e pretendimeve që parashtron. Kërkuesi, si palë e paditur në gjykim, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

7. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), si një e drejtë e natyrës procedurale, duhet të respektohet dhe të përdoret nga çdo subjekt që konsiderohet palë në një proces dhe që preket në mënyrë së drejtpërdrejtë prej tij. Një e drejtë e tillë nuk mund të cenohet, sepse duke qenë një element i së drejtës në tërësi që rrjedh nga thelbi i shtetit të së drejtës, garanton barazinë e palëve në procesin gjyqësor. Për këtë arsye, ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e të drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk mund të kufizohet për asnjë subjekt, përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë *(vendimi nr.22, datë 26.7.2006 i Gjykatës Kushtetuese)*. Lidhur me legjitimimin substancial të kërkuesit, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet vetëm lidhur me pretendimin për cenim të procesit të rregullt

ligjor, për shkak të mosnjoftimit të kërkuesit për të marrë pjesë në gjykim nga Gjykata e Apelit dhe mosshqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë. Pretendimet e tjera janë haptazi të pambështetura.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë

8. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë shkelur nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, duke mos njoftuar Avokaturën e Shtetit për të marrë pjesë në gjykim, në përputhje me nenin 79/a të KPC-së, dhe duke mos shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

9. Në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës, parashikohet: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj". Gjykata është shprehur se në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të dallueshëm dhe asnjë interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) nuk përputhet me qëllimet dhe objektin e tyre. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal *(vendimi nr.14, datë 3.6.2009 i Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata ka pranuar se e drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është tashmë një praktikë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), sipas të cilës do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim (*vendimi nr.11, datë 18.5.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe". Gjykata thekson se e drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës, duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar, në një gjykatë më të lartë, vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Sipas Kushtetutës, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar, të paktën një herë, kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNJ-ja.

11. Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme, vlerëson çështjen e parë nëse vendimi i Gjykatës së Apelit është marrë nëpërmjet një procesi jo të rregullt, në kuptimin kushtetues, për shkak të mosnjoftimit të Avokaturës së Shtetit për të marrë pjesë në gjykim, sipas kërkesave të nenit 79/a të KPC-së.

12. Në bazë të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe ligjit të kohës nr.8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", përfaqësimi dhe mbrojtja e pronës dhe interesave publike nga ana e Avokaturës së Shtetit, në një gjykim të filluar, është një përfaqësim dhe mbrojtje e detyrueshme dhe gjykatat, sipas nenit 79/a të KPC-së, kanë detyrimin që t'i njoftojnë aktet Avokaturës së Shtetit me qëllim që kjo e fundit jo vetëm të ketë mundësi të marrë pjesë në gjykim, por edhe të realizojë mbrojtjen e interesave të shtetit (*shih vendimin nr.27, datë 27.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*. Ky qëndrim gjen mbështetje edhe në vendimin unifikues nr.13, datë 24.3.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që i referohet nenit 1 të ligjit nr.8551, datë 17.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit".

13. Në rastin në shqyrtim, nuk rezulton që Gjykata e Apelit, në gjykimin dhe marrjen e vendimit nr.847, datë 24.6.2009, të ketë plotësuar standardet e gjykimit, në drejtim të dhënies së mundësisë Avokaturës së Shtetit për të siguruar mbrojtjen e interesave të shtetit. Kjo e fundit nuk është njoftuar e nuk i janë dërguar aktet për gjykimin në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Gjykata e Apelit duhet të vlerësonte pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas nenit 1, pika 3 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 dhe ligjit nr.10 018, datë 23.11.2008, ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit.

14. Subjektet e interesuara kanë kundërshtuar pretendimin e mësipërm të kërkuesit duke argumentuar se qëndrimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, për moslegjitimimin e Avokaturës së Shtetit është i

drejtë. Në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit" parashikohet: "Avokatura e Shtetit nuk mund të përfaqësojë dhe as të këshillojë për çështje gjyqësore të një organi qendror të administratës publike kundër një organi vendor dhe anasjelltas". Në çështjen në shqyrtim, Ministria e Drejtësisë është palë paditëse dhe palë e paditur është dhe Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Qarkut Tiranë, e cila, sipas ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", të ndryshuar me ligjin nr.9583, datë 17.7.2006, është person juridik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

15. Gjykata çmon se argumenti i mësipërm i subjekteve të interesuara, për moslegjitimimin e Avokaturës së Shtetit, është i pambështetur. Gjykata e Apelit Tiranë, përveç detyrimeve që i imponoin ligji nr.8551, datë 17.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit" dhe neni 79/a i KPC-së për njoftimin e Avokaturës së Shtetit për të marrë pjesë në gjykim, duhet të mbante parasysh edhe kërkesat e nenit 2 të ligjit nr.9684, datë 6.2.2007 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave", ku parashikohet: "Kundër vendimit të njohjes së të drejtës së pronësisë, kthimit ose kompensimit të pronës, si dhe të të drejtave të tjera reale të zyrës rajonale të AKKP-së në qark, subjekti i shpronësuar ose Avokatura e Shtetit kanë të drejtë të bëjnë ankim…". Kjo Gjykatë, në vendimin nr.27, datë 27.7.2009, ndër të tjera, është shprehur se: "Përderisa kishte pretendime nga secila palë për pronësinë mbi këtë sipërfaqe dhe përderisa përcaktimi i pozicionit të saj kishte lidhje me përcaktimin e pozicionit të trojeve të tjera, gjykatat duhet të vlerësonin pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit, e cila, sipas nenit 1, pika 3 të ligjit nr.8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", ushtron përfaqësimin në gjyq pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit".

16. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se i është cenuar e drejta e aksesit nga vendimi i Gjykatës e Lartë, e cila nuk ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur prej tij. Nga ana e Avokaturës së Shtetit është ushtruar e drejta e rekursit brenda afatit ligjor, i cili është depozituar në datë 22.7.2009 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk e ka shqyrtuar rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit, duke shqyrtuar vetëm rekursin e Ministrisë së Drejtësisë.

17. Gjykata çmon se pretendimi i mësipërm i kërkuesit është i bazuar. Gjykata e Lartë ishte e detyruar të shprehej për rekursin e Avokaturës së Shtetit. Siç rezulton nga materialet e dosjes gjyqësore, rekursi është paraqitur brenda afatit, duke kundërshtuar vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh se Avokatura e Shtetit kishte interes legjitim për ta vënë atë në lëvizje nëpërmjet rekursit, duhet të vlerësonte rekursin nëpërmjet vendimmarrjes sipas nenit 472 të KPC-së.

18. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e të drejtës së tij për proces të rregullt ligjor, në drejtim të së drejtës së aksesit, nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.847, datë 24.6.2009, si dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.881, datë 14.7.2010, janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin e vendimit nr.847 datë 24.6.2009 të Gjykatës së Apelit të Tiranës.
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2010-881, datë 14.7.2010 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Tiranës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Admir Thanza, Sokol Sadushi, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo, Sokol Berberi.

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me përfundimin e arritur në këtë çështje, e çmoj të rëndësishme të dal me mendim pakice.

Shumica ka arritur në përfundimin se, pretendimet e Avokaturës së Shtetit, për cenimin e të drejtës së aksesit, si një nga standardet e procesit të rregullt ligjor, nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.847, datë 24.6.2009, si dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.881, datë 14.7.2010, janë të bazuara dhe, për rrjedhojë, këto vendime duhet të shfuqizohen dhe çështja duhet të rikthehet për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

E konsideroj të rëndësishme të theksoj se, pavarësisht nga shkelja procedurale e nenit 79/a të KPC-së, për shkak të mosnjoftimit të Avokaturës së Shtetit për të marrë pjesë në gjykim, procesi gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë, në tërësinë e tij, nuk ka cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së. Ky qëndrim mbështetet në argumentet që shtjellohen në vijim.

Qëndrimi i shumicës bazohet mbi një përqasje formale, të cilën e gjej të pajustifikuar në këtë çështje. Gjatë procesit gjyqësor që zhvillohet në të gjitha shkallët e gjykimit, mund të konstatohen shkelje të ndryshme, por e rëndësishme është se jo çdo shkelje e ligjit mund të cenojë procesin e rregullt ligjor në aspektin kushtetues. Gjykata, në praktikën e saj, ka pohuar se: "Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, për të investuar Gjykatën Kushtetuese për zgjidhjen e tyre, sa herë shfaqet prezenca e shkeljes së normave procedurale" dhe se "ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj (..). Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë" *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7/2000; nr.25/2005; nr.21/200;, nr.57/2011)*

Edhe GJEDNJ-ja, në linjën e mosmbështetjes së qëndrimeve tepër formale dhe strikte nga gjykatat e vendeve anëtare, ka theksuar detyrimin që kanë këto gjykata për të interpretuar kërkesat procedurale në mënyrë proporcionale dhe të arsyeshme (*shih Stone Court Shipping Company, S.A. kundër Spanjës, 28 tetor 2003, §§ 33-35; Pérez de Rada Cavanilles kundër Spanjës, 28 tetor 1998, § 45; Miragall Escolano dhe të tjerë kundër Spanjës, 25 janar 2000, §§ 36-38)*. Me hyrjen në fuqi të Protokollit 14 të KEDNJ-së, në 1 qershor 2010, është shtuar një kriter i ri për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave, sipas nenit 35 § 3 b) të Konventës së ndryshuar, i cili mbështetet në parimin de minimis non curat praetor. Në esencë, ky parim kërkon që autoriteti përkatës (gjykata rishikuese/gjykata më e lartë, në rastin konkret) nuk duhet të merret me çështje të vogla të papërfillshme. GJEDNJ-ja e ka interpretuar këtë kriter të ri vlerësues si një filtër, duke mos i pranuar kërkesat në rastet kur kërkuesi nuk ka pësuar ndonjë dëm të rëndësishëm/konsiderueshëm, përveç rasteve kur respektimi i të drejtave të njeriut të parashikuara në Konventë (KEDNJ) dhe Protokollet e Konventës, kërkon një shqyrtim të aplikimit për sa i përket thelbit *(shih Korolev kundër Rusisë, no.25551/05, 1 qershor 2010; Rinck kundër Francës, no.18774/09, 19 tetor 2010; Stefanescu kundër Rumanisë, no.11774/04, 12 prill 2011; Burov kundër Moldavisë, no.38875/03, 14 qershor 2011)*.

Nisur nga këndvështrimi dhe standardet e mësipërme, çmoj se, për të arritur në pranueshmërinë e kërkesës dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit, nuk mjafton vetëm të konstatohet shkelja procedurale, por duhet të vlerësohet karakteri i shkeljes dhe pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson, si rrjedhojë e mospjesëmarrjes së tij në gjykimin në Gjykatën e Apelit dhe e mosshqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë. Këto vlerësime trajtohen më poshtë në mënyrë më të detajuar.

Avokatura e Shtetit, sipas ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", që ka qenë në fuqi në kohën kur çështja është shqyrtuar si nga Gjykata e Apelit (2009) ashtu edhe nga Gjykata e Lartë (2010), ka për detyrë të përfaqësojë dhe mbrojë interesat pasurorë të shtetit shqiptar pranë gjykatave kombëtare, ndërkombëtare dhe të huaja, pa autorizim të posaçëm të të përfaqësuarit në çështjet gjyqësore, në të cilat një organ i administratës shtetërore ose Republika e Shqipërisë është palë (neni 5/b). Nga ana tjetër, neni 79/a i KPC-së, imponon detyrimin për gjykatën që, kur shqyrton çështje për të cilat përfaqësimi dhe mbrojtja kryhet nga Avokatura e Shtetit, të urdhërojë njoftimin e akteve kësaj të fundit. Vetëm kështu mund t'i krijohet mundësia reale Avokaturës së Shtetit që të marrë pjesë në gjyq me qëllim përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit, në rastet e parashikuara nga ligji *(shih Vendimin*

Unifikues të Gjykatës së Lartë, nr.13, datë 24.3.2004). Pra, në këtë kuptim, njoftimi i akteve Avokaturës së Shtetit nuk është qëllim në vetvete, por bëhet në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të shtetit. Në këtë linjë ka arsyetuar edhe Gjykata në vendimin nr.27, datë 27.7.2009, ku, ndër të tjera, është shprehur se "Përderisa kishte pretendime nga secila palë për pronësinë mbi këtë sipërfaqe dhe përderisa përcaktimi i pozicionit të saj kishte lidhje me përcaktimin e pozicionit të trojeve të tjera, gjykatat duhet të vlerësonin pretendimet e të gjitha palëve, duke njoftuar e duke ia dërguar aktet e gjykimit edhe Avokaturës së Shtetit…". Në vijim të këtij arsyetimi, mendoj se problemi kryesor që shtrohet është, nëse në këtë çështje interesat e shtetit janë përfaqësuar dhe mbrojtur efektivisht.

Është e vërtetë, siç rezulton nga materialet e dosjes gjyqësore, se Gjykata e Apelit Tiranë nuk ka urdhëruar njoftimin e akteve Avokaturës së Shtetit, për të marrë pjesë në gjykimin e zhvilluar në këtë gjykatë. Për pasojë, gjykata nuk ka respektuar kërkesat e nenit 79/a të KPC-së. Por, është fakt që, në gjykim ka marrë pjesë Ministria e Drejtësisë me cilësinë e palës paditëse. Ministria e Drejtësisë ka kundërshtuar vendimin nr.19, datë 30.3.2001 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Tiranë (KKKP) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në të gjitha gjykimet e zhvilluara për këtë padi, Ministria e Drejtësisë është njoftuar dhe ka marrë pjesë, duke filluar nga vendimi nr.760, datë 27.2.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës dhe duke përfshirë të gjitha shkallët e gjykimit për objektin e kësaj padie. Në vështrim të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë*", i ndryshuar*, dhe në aspektin e përgjithshëm pranohet se Ministria e Drejtësisë, si institucion, përfaqëson interesat e shtetit. Në çështjen konkrete, gjatë gjykimit në Apel dhe Gjykatën e Lartë, Ministria e Drejtësisë ka qenë e pranishme, dhe në cilësinë e paditësit ka përfaqësuar interesat e shtetit në këto instanca gjykimi. Pohimi i faktit se interesat e shtetit janë përfaqësuar në gjykim nga Ministria e Drejtësisë nuk mjafton për të arritur në përfundimin se nuk jemi përpara shkeljeve të tilla procedurale, që e bëjnë procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Në këtë rast, duhet të vlerësohet gjithashtu nëse gjatë gjykimit është respektuar kontradiktorialiteti dhe nëse ka argumente për mbrojtje jo efektive nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë është organ qendror, i cili ka përfaqësuar interesat përkatëse të shtetit në konfliktin gjyqësor ndaj subjekteve të interesuara, nëpërmjet ngritjes së padisë, paraqitjes së argumenteve dhe kundërargumenteve në të gjitha fazat e procesit gjyqësor. Nga dosja gjyqësore rezulton se Ministria e Drejtësisë ka marrë pjesë aktive në të gjitha shkallët e gjykimit dhe nuk janë evidentuar argumente që të venë në diskutim mbrojtjen efektive të Ministrisë së Drejtësisë. Nisur nga këto konstatime, çmoj se është respektuar parimi i kontradiktorialitetit, si një element thelbësor i procesit të rregullt ligjor. Nga analiza e dokumentacionit në dosjen gjyqësore, del qartazi se Avokatura e Shtetit ka qenë e pranishme në shkallën e parë (mund të përmendim këtu seancat e para, përkatësisht në datë 9.5.2006; 24.5.2006; 12.9.2006 e në vazhdimësi) por nuk ka pasur një rol aktiv. Ndërsa në seancën e fundit të shkallës së parë, të zhvilluar në datën 28.12.2007, Avokatura e Shtetit nuk ka qenë e pranishme për të dhënë konkluzionet përfundimtare.

Neni 13 i ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit" parashikon me hollësi dispozitat për fillimin e gjykimit për pavlefshmëri të veprimeve juridike ose kontratave administrative. Kështu, Avokatura e Shtetit, sipas kërkesës së motivuar të organit përgjegjës të institucionit të interesuar, ka të drejtë të fillojë procedurat për ngritjen e padisë, me objekt për pavlefshmëri të veprimit juridik, që tjetërson ose disponon pasurinë shtetërore në favor të të tretëve ose për pavlefshmëri të kontratave administrative, të lidhura me të tretë. Avokatura e Shtetit, përpara se të depozitojë padinë në gjykatë, i paraqet organit të interesuar një raport të hollësishëm për gjendjen e fakteve dhe të ligjit, kostot e pritshme të gjykimit, si dhe për çdo shpenzim të zakonshëm/të jashtëzakonshëm apo çdo dëmshpërblim pasuror/jopasuror, që pala tjetër mund të pretendojë ose të fitojë gjatë apo pas përfundimit të gjykimit për shpalljen e pavlefshme të kontratës ose të veprimit juridik. Në këtë raport, Avokatura e Shtetit është e detyruar të shprehë qëndrimin për ngritjen ose jo të padisë. Nga materialet e dosjes gjyqësore dhe shpjegimet në seancë, nuk rezulton që Avokatura e Shtetit të ketë ndërmarrë ndonjë hap në këtë drejtim apo të ketë paraqitur ndonjë raport në lidhje me çështjen objekt gjykimi.

Në bazë të nenit 1/2 të ligjit nr.10 018, datë 13.11.2008 "Për Avokaturën e Shtetit", Avokatura e Shtetit është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë. Nisur nga ky raport varësie i parashikuar në ligj, Ministria e Drejtësisë i ka pasur të gjitha mundësitë që të informonte Avokaturën e Shtetit mbi çështjen konkrete si dhe t'i kërkonte të merrte pjesë në gjykim si përfaqësuese e interesave të shtetit. GJEDNJ-ja në çështjen Xheraj kundër Shqipërisë, 29 korrik 2008, §58, ka theksuar se, gabimet e autoriteteve shtetërore duhet të shkojnë në favor të të pandehurit. Rreziku i ndonjë gabimi të autoriteteve

shtetërore ose gjykatës duhet të mbartet nga shteti dhe rregullimi i gabimeve nuk duhet t'i ngarkohet individit të interesuar *(përkthim i Gjykatës)*. Në konsideratë të kësaj linje arsyetimi, në çështjen konkrete, është vendosur shfuqizimi i vendimeve gjyqësore dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit, për shkak të moskryerjes së veprimeve sipas ligjit nga ana e organeve shtetërore, duke cenuar në këtë mënyrë, jo për faj të tyre, subjektet e interesuara në gjykim, në cilësinë e pronarëve të tokës.

Përveç sa më sipër, jam i mendimit se shumica duhej të kishte parasysh edhe problemin e afatit të arsyeshëm. Palët e interesuara janë njohur si pronarë të tokës që në vitin 1996. Rikthimi i çështjes sërish në Gjykatën e Apelit ka si efekt të menjëhershëm zgjatjen e procesit gjyqësor dhe mund të sjellë për pasojë cenimin e parimit kushtetues të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

Gjithashtu, interesat e shtetit janë përfaqësuar dhe mbrojtur edhe në Gjykatën e Lartë, nga Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet rekursit, i cili është shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Për më tepër, nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton qartë se, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga Ministria e Drejtësisë, ku janë të përfshira dhe pretendimet e Avokaturës së Shtetit.

Bazuar në sa më sipër, çmoj se, shkeljet procedurale të pretenduara nga Avokatura e Shtetit për procesin gjyqësor në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Lartë, nuk kanë cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, në tërësinë e tij, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së, në atë shkallë që do të kërkonte shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme dhe rikthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Anëtar: Sokol Berberi

VENDIM
Nr.44, datë 7.10.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	"	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	"	"
Petrit Plloçi	Anëtar i	"	"
Vitore Tusha	Anëtare e	"	"
Sokol Sadushi	Anëtar i	"	"
Sokol Berberi	Anëtar i	"	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	"	"
Admir Thanza	Anëtar i	"	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 23.12.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.41/26 Akti që i përket:

KËRKUES: Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar nga Lulzim Lelçaj dhe Jonida Dervishi, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Ilir Beqja, përfaqësuar nga avokatët Genc Çifligu dhe Eno Bushi, me prokurë.

OBJEKTI: Konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të zotit Ilir Beqja.

BAZA LIGJORE: Neni 70, paragrafi 3 dhe 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Admir Thanza; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; subjektin e interesuar që u shpreh për rrëzimin e saj dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në përfundim të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të vitit 2009, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me vendimin nr.602, datë 1.8.2009, ka shpallur kandidatët fitues për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë. Midis fituesve ka qenë edhe Ilir Beqja, i cili është shpallur deputet në Qarkun e Shkodrës. Ai ka bërë betimin si deputet i Kuvendit të Shqipërisë me datë 25.2.2010.

2. Deputeti Ilir Beqja është ortak me 51% të aksioneve në shoqërinë "Intech+" sh.p.k. Ky fakt vërtetohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR), e cila ka lëshuar një vërtetim që i është bashkëngjitur dokumentacionit të paraqitur prej kërkuesit. Shoqëria "Intech+" sh.p.k. ka marrë pjesë në tenderin e shpallur nga Bashkia Durrës në datën 22.10.2009 për informatizimin e kësaj Bashkie dhe është shpallur fituese e tenderit. Shuma e tenderuar për këtë qëllim ka qenë 24.240.000 lekë, e cila i është paguar Shoqërisë "Intech+" pjesërisht në datën 17.2.2010 dhe pjesërisht në datën 21.5.2010.

3. Një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë inicioi procedurën për deklarimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja, për shkak se ai kishte përfituar të ardhura nga fondet publike gjatë kohës që ishte deputet. Për këtë qëllim, deputetët inicues vunë në lëvizje Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, i cili zhvilloi një seancë dëgjimore në prani të deputetit Ilir Beqja. Në përfundim të seancës Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit: "Për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin e deputetit Ilir Beqja". Në datën 21.10.2010, Kuvendi i Shqipërisë e miratoi projektvendimin me shumicë votash.

4. ***Kërkuesi*** pretendon se deputeti Ilir Beqja, në kundërshtim me nenin 70/3 të Kushtetutës, ka përfituar të ardhura nga buxheti i pushtetit vendor nëpërmjet një aktiviteti privat të ushtruar gjatë periudhës që ai ka qenë deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Pavarësisht ditës së betimit, deputeti Ilir Beqja ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë, pasi Kushtetuta e lidh papajtueshmërinë me marrjen e mandatit jo me ushtrimin e tij. Për këtë arsye, bazuar në nenin 70/4 të Kushtetutës, ai kërkon konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja nga Gjykata Kushtetuese.

5. ***Subjekti i interesuar***, deputeti Ilir Beqja, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, në seancën e zhvilluar para kësaj Gjykate, ndër të tjera, deklaroi se:

5.1 Vendimi nr.65, datë 21.10.2010 i Kuvendit është i pavlefshëm, pasi është marrë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit. Votimi është i bërë i hapur, gjë që bie ndesh me parimin e votimit të fshehtë për çështjet që lidhen me personat. Përveç kësaj, pavlefshmëria e vendimit qëndron edhe te fakti se ai nuk ka marrë numrin e duhur të votave të anëtarëve të Kuvendit, duke mos plotësuar shumicën e kërkuar nga neni 78/1 të Kushtetutës, pra kuorumin prej të paktën 71 anëtarë të Kuvendit. Bazuar në nenin 61/1 të Rregullores së Kuvendit, ky vendim është absolutisht i pavlefshëm dhe, si i tillë, nuk ka prodhuar asnjë pasojë juridike.

5.2 Ai nuk është në kushte papajtueshmërie, sepse mandati i tij quhet i filluar në ditën kur ai ka bërë betimin si deputet i Kuvendit të Shqipërisë dhe jo në ditën e shpalljes deputet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Duke qenë se detyrimet e kontratës së lidhur me Bashkinë Durrës janë kryer para kësaj date, ai nuk ndodhet në kushte papajtueshmërie me mandatin e deputetit.

II

Lidhur me vlefshmërinë e procesit të votimit të vendimit nr.65, datë 21.10.2010 të Kuvendit të Shqipërisë

6. Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Ilir Beqja, pretendoi se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi vendimi i Kuvendit nr.65, datë 21.10.2010, me anë të të cilit është vendosur dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja, është i pavlefshëm. Pretendimi për pavlefshmëri bazohet në dy shkaqe: i pari i referohet procesit të votimit të hapur dhe jo të fshehtë, i dyti ka të bëjë me mosarritjen e kuorumit të përcaktuar nga Kushtetuta për miratimin e vendimit objekt shqyrtimi. Sipas subjektit të interesuar, në sallën e Kuvendit kanë qenë prezent 140 deputetë, ndërsa në votim kanë marrë pjesë 139 deputetë. Kanë votuar pro vendimit 70 deputetë, kundër vendimit 67 deputetë dhe kanë abstenuar 2. Shkaku që vota e një deputeti mungon, sipas subjektit të interesuar, ka qenë se vota e tij nuk është numëruar qëllimisht. Për këtë arsye, rezulton që numri i votave pro të jetë më i vogël se ai i kërkuar, pra në vend të 71 deputetë

që duhet të votonin pro vendimit kanë votuar vetëm 70. Ky numër nuk përbën shumicën e deputetëve të pranishëm sipas nenit 78/1 të Kushtetutës dhe vendimit interpretues nr.29/2009 të kësaj Gjykate. Për këto arsye, ai pretendon se vendimi për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja është i pavlefshëm.

7. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) vlerëson se pretendimi i subjektit të interesuar është i pabazuar dhe nuk duhet pranuar. Lidhur me shkakun e parë për pavlefshmërinë e votimit, pra të votimit të hapur ose të fshehtë, Gjykata vëren se Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Rregullorja e Kuvendit nuk parashikojnë mënyrën e votimit për raportin e 1/10 së anëtarëve të Kuvendit, kur vendoset dërgimi i çështjes në Gjykatën Kushtetuese për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Megjithatë, parimisht, sa i takon mënyrës së votimit në Kuvend, Gjykata vlerëson se vota e deputetëve nuk është e detyrueshme të jetë e fshehtë në të gjitha rastet, pasi deputetët janë pjesë e një organi ku formohet vullneti politik. Deputetët nuk kanë detyrim që, gjatë veprimtarisë së tyre, të jenë të paanshëm ose të pavarur politikisht, pasi ata nuk janë nëpunës publikë, gjyqtarë ose funksionarë të tillë nga të cilët pritet vendimmarrje e paanshme politike. Deputetët janë funksionarë të mandatuar politikisht dhe zgjedhësit presin prej tyre të sillen si të tillë duke respektuar parimet kushtetuese në një demokraci parlamentare.

8. Nisur nga ky fakt, Gjykata vlerëson se mënyra se si duhet votuar (hapur apo fshehtë), në rastet kur nuk është përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit mund të vendoset nga vetë deputetët, sipas rastit dhe çështjes, duke iu referuar edhe praktikave të mëparshme të ngjashme, nëse ka. Pranohet se në praktikën e parlamenteve operohet kryesisht me votim të fshehtë kur vendoset për persona (kryesisht në procese të emërimit dhe shkarkimit të tyre), për shkak se votimi i hapur mund të sjellë një paragjykim të personit që voton ose votohet dhe do të mund të ndikonte në sjelljen e deputetit ose shprehjen e vullnetit të tij politik, në rast se do të votonte në mënyrë të hapur.

9. Në çështjen në shqyrtim, subjekti i interesuar pretendon se meqë votimi për miratimin e vendimit të Kuvendit kishte të bënte me një deputet konkret, si rrjedhojë votimi duhej të ishte bërë i fshehtë. Gjykata thekson se, në çështjen konkrete, anëtarët e Kuvendit nuk votuan për heqjen ose për pavlefshmërinë e mandatit të deputetit Ilir Beqja, por votuan për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar ose jo papajtueshmërinë e mandatit të tij. Rezultati i votimit në Kuvend nuk solli shpalljen e papajtueshmërisë ose përfundimin e mandatit të deputetit, por vetëm vënien në lëvizje të Gjykatës, siç parashikohet në nenin 70/4 të Kushtetutës. Është kjo Gjykatë që vendos nëse ka shkaqe për të konstatuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetit.

10. Gjykata sjell në vëmendje vendimin e saj të mëparshëm, ku është shprehur se *"…Kuvendi është organi që me rregullore interpreton jo vetëm normat kushtetuese por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. Në vendimin nr.75, datë 19.4.2002, Gjykata ka nënvizuar se pavarësisht nga rregullimi në Kushtetutë apo në ligj i procedurave të shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit, një gjë e tillë nuk e pengon Kuvendin të adaptojë rregulla të veçanta për çdo rast konkret apo për të gjitha rastet në tërësi…kur Kuvendi bën vetë interpretim të normave që nuk janë parashikuar nga Kushtetuta, por i takojnë interpretimeve e diskrecionit të vetë organit, Gjykata nuk mund të arrijë në konkluzione se votimi i hapur i Kuvendit në këtë çështje përbën element të një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues." (Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.21/2008)*. Për këto arsye, Gjykata vlerëson se mënyra e votimit të hapur nuk e bën të pavlefshëm vendimin e Kuvendit për këtë çështje.

11. Sa i takon argumentit të dytë lidhur me pavlefshmërinë e vendimit të Kuvendit nr.65, datë 21.10.2010, pra të mosarritjes së shumicës së kërkuar për miratimin e tij, Gjykata çmon se ky pretendim nuk është i bazuar. Neni 78 i Kushtetutës parashikon se "*Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar.*" Në mbështetje të kësaj dispozite është miratuar neni 55/1 i Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit "*ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga Kuvendi, kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur në Kushtetutë parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre"*. Koncepti i shumicës së votave lidhet, në kuptimin primar të saj, me votimin pro ose kundër të gjysmës së votave të anëtarëve të organit që voton plus një votë. Ndryshe kjo njihet edhe me shprehjen shumicë e thjeshtë. Për të arritur këtë shumicë duhet të llogaritet paraprakisht kuorumi i domosdoshëm që kërkohet të votojë dhe më pas të verifikohet numri i të pranishmëve në procesin e votimit. Me qëllim plotësimin e kuorumit të domosdoshëm llogariten edhe abstenimet, megjithëse nuk ndikojnë në rezultatin e votimit.

12. Gjykata, në një vendim interpretues të saj, ka arritur në përfundimin se numri i anëtarëve të pranishëm për zhvillimin e procedurave vendimmarrëse është të paktën gjysma plus një e të gjithë

anëtarëve të Kuvendit, pra 71 deputetë. Rritja e pranisë në procesin e votimit mbi kuorumin e domosdoshëm sjell rritje të numrit të anëtarëve që votojnë. Vendimi i Kuvendit konsiderohet i miratuar kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm (*Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.29/2009*).

13. Vendimi nr.65, datë 21.10.2010 i Kuvendit, sipas interpretimit të mësipërm të Gjykatës, në kushtet kur votojnë të gjithë deputetët e pranishëm, duhet të votohej me 71 vota pro. Në rastin konkret, është votuar fillimisht për praninë e deputetëve në sallë me qëllim përcaktimin e kuorumit të domosdoshëm për votimin e kërkesës së grupit të deputetëve. Sipas tabulateve të Kuvendit të Shqipërisë, rezulton se lidhur me praninë në sallë kanë votuar 137 deputetë. Pas verifikimit të pranisë së deputetëve në sallë, në një interval kohor prej disa minutash, është votuar për kërkesën e një grupi deputetësh të Kuvendit për dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese. Sipas tabulateve të këtij votimi, rezulton të kenë votuar 139 deputetë. Nga këta, 70 deputetë kanë votuar pro, 67 deputetë kundër dhe 2 kanë abstenuar. Nga procesverbali i votimit rezulton se 3 deputetë (P. Stërkaj, D. Tahiri dhe F. Tushe) nuk kanë votuar për praninë në sallë por kanë votuar lidhur me kërkesën e grupit të deputetëve. Ndërsa një deputet (F. Toçi), megjithëse ka votuar për praninë e tij në sallë, nuk ka votuar lidhur me kërkesën e grupit të deputetëve. Kjo ka sjellë që numri i deputetëve sipas votimit për praninë të mos përputhet me numrin e deputetëve që kanë votuar lidhur me kërkesën. Për sa më sipër, Gjykata konfirmon qëndrimin e saj të mëparshëm se për përcaktimin e kuorumit në një proces votimi duhet t'i referohemi vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar dhe jo numrit të përgjithshëm të deputetëve që ndodhen në sallë dhe që nuk votojnë (*vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.29/2009*).

14. Gjykata çmon se një deputet që nuk shpreh vullnet me votën e tij dhe si rrjedhojë nuk ndikon në procesin e votimit në Kuvend nuk duhet të llogaritet në konceptin "shumicë e të pranishmëve" për efekt të kuorumit të votimit. Nëse do të pranonim të kundërtën, atëherë do të prodhohej një rritje artificiale dhe e pajustifikuar e kuorumit, gjë e cila nuk është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit.

15. Sa i takon pretendimit të subjektit të interesuar se deputeti F. Toçi ka votuar lidhur me kërkesën e grupit të deputetëve, por vota e tij nuk është llogaritur qëllimisht, Gjykata vlerëson se në seancë nuk u soll asnjë provë që të vërtetojë këtë pretendim.

16. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vendimi i Kuvendit për dërgimin e çështjes para saj për konstatimin e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të zotit Ilir Beqja është votuar rregullisht dhe ka marrë shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që kanë votuar.

III

A. Lidhur me momentin e fillimit dhe të mbarimit të mandatit të deputetit sipas nenit 71/1 të Kushtetutës

17. Doktrina mbizotëruese e përkufizon mandatin parlamentar si një akt të kalimit të sovranitetit nga populli tek përfaqësuesit e tij. Përfaqësimi, në kontekstin e mandatit parlamentar, nënkupton delegimin e të drejtës nga shumë persona tek një person i vetëm për të vendosur mbi çështje që lidhen me qeverisjen e vendit. Çdo qytetar konsiderohet si mbajtës i një copëze të barabartë të sovranitetit, i cili, i marrë në shumën totale të tij, bën të mundur marrjen e vendimeve nga mbajtësi i sovranitetit që është populli, nëpërmjet përfaqësimit të tij nga deputeti[1].

18. Në një sistem ku sundon sovraniteti popullor dhe parimi i demokracisë indirekte qeverisja realizohet nëpërmjet vullnetit të shumicës në parlament. Parlamentarët, nëpërmjet mandatit të marrë nga zgjedhësit, ushtrojnë sovranitetin kombëtar. Mandati parlamentar, në parim, është i përgjithshëm, domethënë parlamentarët përfaqësojnë kombin si të tërë dhe jo një grup votuesish, gjithashtu, ai është dhe përfaqësues, që do të thotë se deputetët nuk janë të lidhur pas ndonjë urdhri apo dëshire që vjen nga elektorati. Parlamentarët gëzojnë pavarësi të plotë përballë elektoratit por edhe ndaj grupimit politik ku ata bëjnë pjesë. Ata mund të largohen apo bashkohen sipas dëshirës dhe vullnetit të tyre. Për këtë arsye, pranohet se mandati parlamentar në një demokraci është i parevokueshëm.

19. Gjykata vlerëson se koncepti i mandatit parlamentar përmban detyrimin e përfaqësimit real të zgjedhësve. Populli merr pjesë në vendimmarrjen parlamentare nëpërmjet tërësisë së anëtarëve të tij dhe për këtë qëllim duhet të garantohet pjesëmarrja e të gjithë deputetëve në vendimmarrje sipas kuadrit kushtetues të parashikuar për sistemin demokratik-parlamentar. Nga parimi i demokracisë përfaqësuese

[1] *Jean Jacques Rousseau,* The Social Contract, Libri II, nëntitulli: Sovereignity is indivisible (1762, i ribotuar).

rrjedh detyrimi i deputetit që mandatin e besuar nga zgjedhësit ta ushtrojë realisht. Vetëm duke qenë plotësisht efektiv, pra i përfaqësuar tërësisht me të gjithë anëtarët e tij, parlamenti mund të realizojë funksionin e tij demokratik[2].

20. Nga parimi i mandatit përfaqësues dhe të pavarur nga urdhrat dhe ndikime të tjera rrjedhin disa pasoja juridike të tilla si: mosdetyrimi i deputetit për të qenë apo mbetur pjesë e një grupi parlamentar të caktuar, mosrevokimi i mandatit nga zgjedhësit apo partia politike etj. Mandati i deputetit duhet të kuptohet së pari si një akt përfaqësimi individual që lidhet me deputetin si individ dhe më pas me partinë politike ku ai bën pjesë. Si i tillë, deputeti ushtron në pavarësi të plotë mandatin e tij duke vendosur në bazë të veprimtarisë së tij interesin e të përfaqësuarve. Këtë ai e bën duke marrë vendime me vullnet dhe bindje të plotë, të cilat jo gjithmonë korrespondojnë me vullnetin e zgjedhësve që ai përfaqëson ose të grupimit politik ku bën pjesë.

21. Megjithëse kushtetutat e vendeve demokratike përcaktojnë se deputeti është përfaqësues i të gjithë popullit, i njohur ndryshe si *parimi i ndalimit të mandatit detyrues*, është logjike që ai nuk mund ta ushtrojë funksionin e tij i vetëm por në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të parlamentit me qëllim funksionimin sa më normal të këtij të fundit. Nëse një deputet, për arsye të ndryshme, ndalohet ose pengohet të ushtrojë funksionin e tij si pjesë e parlamentit, atëherë cenohet parimi i përfaqësimit, si dhe raporti shumicë/pakicë i vendosur nga vullneti i zgjedhësve dhe që duhet të gjejë patjetër pasqyrim në parlament gjatë gjithë legjislaturës. Në një situatë të tillë deputeti nuk do të ishte në gjendje të sillte në parlament, aty ku formohet dhe shprehet vullneti politik i zgjedhësve, përvojën, bindjet dhe aftësitë e tij me qëllim qeverisjen sa më të mirë të vendit. Në raste të tilla duhet të gjejë zbatim parimi se *çdo deputet është i rëndësishëm individualisht dhe si i tillë përbën një element të pandashëm nga tërësia e parlamentit*[3].

22. Në këtë vështrim të përgjithshëm të mandatit parlamentar duhet parë edhe marrëdhënia e deputetit si individ me organin përfaqësues si i tërë. Deputeti është mbajtës i mandatit të lirë, i besimit të shprehur të zgjedhësit me anë të votës për ta përfaqësuar atë gjatë gjithë periudhës që zgjat legjislatura. Pra, në radhë të parë, mandati që i jepet deputetit ka si qëllim kryesor funksionimin sa më të mirë të parlamentit dhe jo drejtpërdrejt garantimin e deputetit si individ. Për këtë arsye, megjithëse mandati i deputetit, në pamje të parë, mund të konsiderohet si individual, ai nuk mund të kuptohet i shkëputur nga mandati i Kuvendit. Aspekti individual i mandatit parlamentar qëndron tek fakti se deputeti, me qëllim që të ushtrojë mandatin e përfaqësimit në mënyrë sa më korrekte dhe pa pengesa (për shkaqe politike ose jo) "vishet" me një mburojë ndaj ndërhyrjeve të paligjshme të pushteteve të tjera ose të vetë zgjedhësve. Nga ana tjetër, aspekti kolektiv i mandatit parlamentar i referohet mbrojtjes së vetë organit ligjvënës si i tërë dhe jo deputetëve të veçantë, si pjesë të tij. Deputetët përfitojnë nga kjo mbrojtje për aq kohë sa janë pjesë e organit ligjvënës dhe në ato raste dhe sipas kushteve që parashikon shprehimisht kushtetuta e një vendi.

23. Gjykata thekson se neni 70/1 i Kushtetutës parashikon shprehimisht se deputeti gëzon mandat të lirë. Kjo mbrojtje kushtetuese shtrihet natyrshëm edhe ndaj ushtrimit faktik të tij. Deputeti ushtron mandatin e tij të lirë nga çdo lloj ndërhyrje, në pavarësi të plotë, dhe pa iu nënshtruar urdhrave apo kërkesave të ndryshme, por vetëm bindjes dhe ndërgjegjes së tij. Pavarësia e mandatit të deputetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, i shërben forcimit të statusit përfaqësues parlamentar duke garantuar edhe të drejtat e pakicës parlamentare brenda sistemit të vendimmarrjes me shumicë. Deputeti është i lirë të ushtrojë funksionin e tij në mënyrën më të mirë të mundshme të zgjedhur prej tij. Nga tërësia e karakteristikave që mbart në vetvete mandati parlamentar, është e qartë se deputeti gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk i nënshtrohet urdhrave, ndryshe nga pjesa tjetër e punonjësve ose nëpunësve të shërbimit civil. Ai pranon në mënyrë krejtësisht të lirë mandatin e tij dhe vendos me përgjegjësinë e tij të plotë mbi mënyrën e ushtrimit të mandatit[4]. Veprimtaria e tij si deputet duhet të përshkohet gjatë gjithë kohës që ai ushtron këtë funksion nga përgjegjshmëria, ndershmëria dhe korrektesa. Ky detyrim për deputetin fillon që në momentin e fillimit të mandatit parlamentar.

24. Kushtetuta jonë parashikon dy momente të ndryshme që lidhen me fillimin e mandatit të deputetit: neni 71/1 parashikon se mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni

[2] Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BverfGE 1/06, 4.7.2007.
[3] *Richard Wurbs,* Regelungsprobleme der Immunität und der Indemnität in der parlamentarishen Praxis (1988) fq. 24-27.
[4] Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BVerfGE 76, 265, 341.

përkatës i zgjedhjeve (kupto:KQZ); neni 72 parashikon se para fillimit të ushtrimit të mandatit deputetët bëjnë betimin në Kuvend. Bazuar në këtë ndarje të momenteve, pra fillimit të mandatit dhe fillimit të ushtrimit të mandatit të deputetit, si dhe për shkak të pretendimit kryesor të subjektit të interesuar se mandati i deputetit fillon kur ai bën betimin dhe para betimit nuk konsiderohet deputet, Gjykata vlerëson se është e nevojshme të ndalet tek dallimi midis këtyre momenteve.

a) Dallimi midis fillimit të mandatit dhe fillimit të ushtrimit të mandatit parlamentar

25. Kushtetutat bashkëkohore demokratike, në mënyrë të shprehur ose duke ia deleguar ligjvënësit të thjeshtë, përgjithësisht, bëjnë një dallim midis momentit të fillimit të mandatit parlamentar dhe momentit të fillimit të ushtrimit të këtij mandati. Ky dallim bëhet me qëllim përcaktimin e momentit të ardhjes së efekteve të caktuara për secilën prej këtyre fazave. Kështu, në mjaft vende europiane, si momenti kur kandidati konsiderohet deputet quhet momenti kur ai shpallet i tillë nga organi i ngarkuar me nxjerrjen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Kështu, Rregullorja e Dhomës së Ulët të Parlamentit Austriak parashikon se në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar, kandidati fitues konsiderohet deputet dhe gëzon të drejtën e vendit në parlament dhe të votës[5]. Anëtarësia e plotë, pra gëzimi i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të deputetit fillon me mbledhjen e parë të parlamentit, ku bëhet edhe betimi i deputetëve[6].

26. Ligjvënësi gjerman fillimin dhe përfundimin e mandatit e ka të rregulluar jo në Kushtetutë por në ligjin federal për zgjedhjen e organeve përfaqësuese. Ky ligj parashikon se një kandidat i zgjedhur e fiton anëtarësinë në Bundestag pas deklarimit përfundimtar të rezultatit të zgjedhjeve nga komisioni zgjedhor. Refuzimi i fitimit të anëtarësisë duhet të bëhet para mbledhjes së parë të Bundestag-ut dhe t'i dorëzohet me shkrim kryetarit të komisionit zgjedhor[7]. Refuzimi i marrjes së mandatit mund të bëhet edhe para mbledhjes së parë të parlamentit të ri, pa bërë ende betimin. Kuptohet që mandati konsiderohet i filluar nga momenti i shpalljes së fituesit nga komisioni zgjedhor, përndryshe nuk do të kishte asnjë kuptim dhe vlerë juridike bërja e deklaratës për refuzim të mandatit, nëse deputeti nuk e ka ende një të tillë. Rregullime të ngjashme gjejmë edhe në kuadrin kushtetues dhe ligjor të vendeve të tilla si: Polonia[8], Estonia[9], Finlanda[10], Luksemburgu[11], Rumania[12], Ukraina[13], Lituania[14] etj.

27. Kushtetuta jonë parashikon si moment të fillimit të mandatit parlamentar atë të shpalljes së deputetit nga komisioni përkatës i zgjedhjeve (neni 71/1). Kurse si moment i fillimit të ushtrimit të mandatit konsiderohet ai i betimit (neni 72). Gjithashtu, Kushtetuta e lidh momentin e fillimit të punës së Kuvendit të ri me shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve (neni 67/1), pra jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e zgjedhjeve. Në mbledhjen e parë bëhet konstituimi i tij, i cili realizohet pas betimit të deputetëve. Kuvendi i vazhdon punimet deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri (neni 65/3). Gjykata çmon se duke i interpretuar literalisht këto dispozita dhe në tërësi arrihet në përfundimin se: i) deputeti konsiderohet i tillë që në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe vazhdon të jetë deputet deri në konstituimin e parlamentit pasardhës, pra në mbledhjen e parë të tij; ii) deputeti fillon ushtrimin e detyrës së tij në momentin e betimit, pas të cilit fillon dhe gëzimi i disa të drejtave dhe detyrave që lidhen me mandatin parlamentar; iii) Kuvendi i ri fillon mandatin në mbledhjen e parë pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve dhe vazhdon deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri.

28. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se mandati i deputetëve lidhet me mandatin e Kuvendit, pasi marrja ose fitimi i mandatit nga deputetët konsiderohet si kusht paraprak për të filluar mandati i vetë Kuvendit, i cili thirret në mbledhjen e parë të tij me pjesëmarrjen e deputetëve të zgjedhur dhe jo të kandidatëve për deputetë. Nëse do të pranonim të kundërtën, atëherë do të rezultonte që Kuvendi i ri mblidhet në seancën e parë të tij në praninë e personave pa mandat për të qenë pjesëmarrës në të. Gjykata thekson se mandati i deputetit nuk fitohet në Kuvend, ai fitohet gjatë një procesi votimi të

[5] Neni 113 i Ligjit për Zgjedhjen e Anëtarëve të Dhomës së Ulët (Nationalrat-NRWO) dhe neni 1/1 i Rregullores së Dhomës së Ulët të Parlamentit Austriak (GeOG).
[6] Neni 4 i Rregullores së Dhomës së Ulët të Parlamentit Austriak (GeOG).
[7] Neni 45 i Ligjit Federal Gjerman për Zgjedhjet.
[8] Neni 98 i Kushtetutës së Polonisë.
[9] Neni 61 i Kushtetutës së Estonisë.
[10] Neni 24 i Kushtetutës së Finlandës.
[11] Neni 57 i Kushtetutës së Luksemburgut.
[12] Neni 67/1 i Kushtetutës së Rumanisë.
[13] Neni 79 i Kushtetutës së Ukrainës.
[14] Neni 60/1 i Kushtetutës së Lituanisë.

përgjithshëm ku zgjedhësit shprehin lirshëm preferencën e tyre për kandidatët. Në fund të procesit zgjedhor, kandidati që ka marrë shumicën e votave, konsiderohet se ka fituar edhe mandatin e deputetit. Kuvendi, në seancën e parë të tij, bën vetëm verifikimin e mandatit të deputetit, pra, nëse personi që ka fituar mandatin e deputetit përputhet me personin e ndodhur në sallë ditën e konstituimit (rasti i vdekjes, dorëheqjes, pamundësisë fizike e mendore etj.), si dhe verifikon nëse ka kushte pazgjedhshmërie ose papajtueshmërie nga ato të parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji.

29. Gjykata thekson se një akt tjetër që realizohet gjatë mbledhjes së parë të Kuvendit të ri është edhe betimi i deputetëve. Betimi është një akt që shërben për të deklaruar vullnetin, gatishmërinë, bindjen dhe vendosmërinë e mëtejshme të deputetit të mandatuar për të ushtruar funksionin e përfaqësuesit në Kuvendin e ri, në përputhje me rregullat e parashikuara për këtë qëllim. Betimi nuk është kusht për të bërë të vlefshëm mandatin e deputetit, pasi këtë e ka bërë komisioni zgjedhor, i cili e ka shpallur atë fitues nga votat e marra prej zgjedhësve. Mosbërja e betimit përbën një nga shkaqet e humbjes së mandatit parlamentar[15]. Ky parashikim është bërë edhe për raste të tjera të fillimit të detyrës si p.sh nga Presidenti i Republikës[16], gjyqtarët etj.

30. Kushtetuta jonë parashikon se çdo deputet, në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri, bën betimin se "*Do të kryej me ndërgjegje detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve."*[17] Arsyet kur deputeti mund të shtyjë bërjen e betimit janë ato të njohura dhe të gjithëpranuara, si p.sh paaftësia e përkohshme fizike, ose shkaqe të tjera arsyeshme (ndodhja e përkohshme jashtë vendit, forca madhore që pengojnë prezencën e tij në Kuvend në momentin e betimit etj.). Deputeti ka detyrimin të shmangë, për aq sa është e mundur, pengesat që çojnë në mosbërjen e betimit, pasi një gjë e tillë jo vetëm bie ndesh me thelbin e mandatit parlamentar dhe detyrimin e deputetit ndaj zgjedhësve, por çon edhe në përfundimin e mandatit parlamentar. Prandaj, është përgjegjësi individuale e deputetit të marrë masat me qëllim bërjen e betimit në mbledhjen më të parë të Kuvendit dhe jo të përdorë mosbërjen e betimit si arsye për të mospërmbushur detyrimet e tij kushtetuese dhe ligjore. Një veprim i tillë nuk pajtohet me parimet e një shteti demokratik dhe të së drejtës. Mosbërja e betimit nga deputeti nuk e përjashton atë nga detyrimi për t'iu nënshtruar detyrimeve ligjore.

31. Gjykata çmon që megjithëse ligjvënësi kushtetues ka preferuar ta ndajë momentin e fillimit të mandatit nga momenti i fillimit të ushtrimit të mandatit, në fakt të dyja janë pjesë e një të tëre, pra e fillimit të punës së Kuvendit të ri. Si shpallja e deputetit i tillë nga komisioni zgjedhor ashtu dhe betimi i tij në mbledhjen e parë të parlamentit të ri lidhen me ushtrimin e plotë dhe funksional të mandatit parlamentar[18]. Nisur nga parimi i pavarësisë së mandatit parlamentar ose i mandatit të lirë, i cili është i garantuar nga neni 70/1 i Kushtetutës, deputeti gëzon një status kushtetues si pjesë e rëndësishme e parlamentit me të drejtat e veta. Statusi kushtetues i deputetit, i shprehur në nenin 70/1 dhe 73 të Kushtetutës, shtrihet që nga momenti i fitimit të mandatit dhe vazhdon deri në përfundimin e mandatit parlamentar. Gjithashtu, edhe të drejta të tjera si: mbrojtja nga ndjekja penale (imuniteti penal), mospërgjegjësia për deklarimet dhe votën e dhënë (indemniteti), e drejta për të përfituar një shpërblim për punën e tij si anëtar i parlamentetit (bashkë me përfitime të tjera) janë pjesë e statusit të tij kushtetues, të cilat ai i gëzon nga momenti i anëtarësisë në parlament[19]. Vetëm duke i parë të plota të drejtat dhe detyrimet, si pjesë e tërë e mandatit parlamentar, mund të kuptohet siç duhet kompleksiteti i rolit të përfaqësimit, parashikuar nga neni 2/2 i Kushtetutës sonë.

32. Një nga pyetjet që shtrohet para Gjykatës në këtë çështje është: *Kur fillojnë efektet e mandatit parlamentar për deputetin, në momentin e shpalljes së tij deputet nga komisioni zgjedhor, apo në momentin që ai bën betimin në parlament*? Gjykata thekson se detyrimi i deputetit për të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim përfaqësimin sa më të mirë të zgjedhësve dhe ushtrimin e mandatit të tij konform detyrimeve kushtetuese dhe ligjore duhet të fillojë që në periudhën parazgjedhore (përfshi këtu edhe fushatën zgjedhore). Përgatitja për marrjen e një funksioni publik përfshin edhe plotësimin e detyrimeve morale dhe shoqërore kundrejt publikut para detyrimeve ligjore. Gjykata vlerëson se nuk pritet patjetër nga zgjedhësit që kandidati të heqë dorë nga çdo burim jetese para se të zgjidhet deputet,

[15] Neni 71/2 "a" i Kushtetutës dhe neni 4 i Rregullores së Kuvendit.
[16] Neni 88/3 i Kushtetutës.
[17] Neni 4 i Rregullores së Kuvendit.
[18] *Horst Dreier*, Grundgesetz-Kommentar (1998) fq. 832.
[19] Shih për më tepër ligjin nr.8550, datë 18.11.1999 "Për statusin e deputetit".

pasi një gjë e tillë bie ndesh me të drejtën e tij individuale për një jetë të denjë. Por ai duhet të marrë të gjitha masat për të shmangur çdo situatë papajtueshmërie apo konflikti interesi që mund të lindë në momentin e marrjes (fillimit) së mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës që ai vazhdon. Veprimet konkrete për këtë qëllim nevojiten të merren më së voni deri në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe qartësia tek deputeti për të ardhurat e tij financiare. Pavarësisht kësaj, Gjykata thekson se pasojat juridike të mandatit fillojnë në momentin që kandidati shpallet deputet nga KQZ-ja. Nga ky moment deputeti është i detyruar të plotësojë të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore që lidhen me ndalimin e kryerjes së aktiviteteve të tjera apo deklarimet lidhur me interesat e tij financiarë, siç parashikon Kushtetuta në nenin 70 të saj dhe ligjet e tjera përkatëse.

b) Lidhur me përfundimin e mandatit parlamentar

33. Neni 65/3 i Kushtetutës parashikon se "*mandati i Kuvendit vazhdon deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri.*" Arsyet e këtij parashikimi Gjykata i gjen tek disa faktorë. *Së pari*, ky parashikim i shërben parimit të vazhdimësisë të organeve kushtetuese dhe eliminimit të boshllëkut institucional. Në një shtet demokratik institucionet, sidomos ato kushtetuese, duhet të reflektojnë vazhdimësi të funksionimit të tyre me qëllim përçimin e sigurisë tek populli se, pavarësisht rotacioneve politike dhe institucionale, ekzistenca e institucioneve dhe funksionimi normal i tyre nuk rrezikohet. *Së dyti*, arsye tjetër është edhe garantimi i një situate të qëndrueshme (jo vetëm financiare) për ata deputetë që duan të konkurrojnë përsëri në zgjedhjet e reja parlamentare. Deputetët vazhdojnë të konsiderohen të tillë deri në mbledhjen e parë të Kuvendit të ri dhe ky rregullim shmang ose zvogëlon shqetësimin e tyre për mjetet e jetesës gjatë kohës që konkurrojnë përsëri si deputetë ose përpiqen të ridimensionohen në tregun e punës. *Së treti*, arsyeja që ligjvënësi ka parashikuar një rregullim të tillë ka të bëjë edhe me faktin që, edhe sikur formimi i Kuvendit të ri të zgjasë, ose zgjedhjet të mos zhvillohen për arsye të ndryshme, mbledhja e Kuvendit ekzistues të jetë e mundur në raste të jashtëzakonshme.

34. Duke iu referuar arsyetimit të mësipërm për kohëzgjatjen e mandatit të Kuvendit, Gjykata vlerëson se, pavarësisht se në pamje të parë dhe në një situatë hipotetike mund të prezumohet se në periudhën midis daljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të reja dhe mbledhjes së parë të Kuvendit të ri, kemi të bëjmë me dyfishin e numrit të deputetëve të parashikuar nga Kushtetuta, pra 280 deputetë, kjo është thjesht një mundësi teorike dhe jo praktike. Deputetët e Kuvendit "të vjetër" konsiderohen ende anëtarë të tij deri në mbledhjen e Kuvendit "të ri" por ata nuk e ushtrojnë më *de facto* këtë detyrë, përveç rasteve të jashtëzakonshme të parashikuara nga Kushtetuta. Ndërsa deputetët e Kuvendit "të ri" fillojnë ta ushtrojnë detyrën kur bëjnë betimin në mbledhjen e parë të tij, i cili shënon dhe fundin e mandatit të deputetëve "të vjetër". Në këtë kuptim, numri real i deputetëve gjatë tërë kohës është ai i parashikuar nga neni 64/1 i Kushtetutës, pra 140 deputetë.

B. Lidhur me konceptin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit sipas nenit 70/3 të Kushtetutës

35. Gjykata vlerëson se, para se të arrijë në konkluzione lidhur me konstatimin e papajtueshmërisë së deputetit Ilir Beqja, të ndalet në elaborimin e konceptit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit. Koncepti i papajtueshmërisë, në legjislacione të ndryshme, është i përfshirë pjesërisht në kushtetutë, pjesërisht në ligje të veçanta. Papajtueshmëria me funksionin e deputetit nënkupton që deputeti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër përveç atij të anëtarit të parlamentit ose anëtarit të qeverisë[20]. Në thelb papajtueshmëria përqendrohet në dy aspekte: *e para* lidhet me ndalimin për të mbajtur dy funksione publike, *e dyta,* me ndalimin për të mbajtur një funksion publik dhe një privat me karakter ekonomik (ose jo). Në të dyja rastet, ndalimi për të mbajtur dy funksione/detyra synon parandalimin e mbivendosjes së kompetencave të ndara tek i njëjti person ose organ dhe në këtë mënyrë moscenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe si rrjedhojë të shtetit të së drejtës. Gjithashtu, ndalimi i ushtrimit të më shumë se një funksioni/detyre parashikohet për të garantuar edhe angazhimin e plotë dhe pa rezerva të funksionarit në kryerjen e detyrës së marrë përsipër prej tij, gjë e cila mund të reduktohej ose të bëhej e pamundur për shkak të angazhimit të veçantë që kërkon kryerja e njëkohshme e dy detyrave nga funksionari[21]. Instituti i papajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit të dhënë dhe garancitë e paanshmërisë së të zgjedhurit. Ai konsiston në pamundësinë juridike për të mbajtur një detyrë për të cilën subjekti është zgjedhur në mënyrë të vlefshme ose të zhvillojë disa

[20] Neni 70/2 i Kushtetutës.

[21] *Walter/Mayer,* Bundesverfassungsrecht (2000) fq.180.

aktivitete të caktuara të konsideruara nga ligjvënësi si të papajtueshme me mandatin elektoral[22].

36. Gjykata thekson se kuptimi i papajtueshmërisë qëndron kryesisht tek parimi i ndarjes së pushteteve, por edhe tek parimi i shtetit neutral, sipas të cilit organet shtetërore ose pjesë të tyre nuk duhet të jenë të lidhur ose të varur nga interesa ekonomikë. Për papajtueshmërinë, si koncept ndalues i kryerjes së më shumë se një detyre/funksioni, nuk është e rëndësishme nëse funksionari bie në kushtet e përfitimit për shkak të detyrës ose jo ose në konflikt interesi midis detyrës së tij dhe interesave privatë. Vetëm fakti i ushtrimit të dy funksioneve/detyrave (publike-publike, publike-private) mjafton që ai të konsumojë këtë ndalim. Duke qenë se në çështjen objekt shqyrtimi shtrohet kërkesa për konstatimin e papajtueshmërisë midis një funksioni publik dhe një funksioni privat me karakter fitimprurës që buron nga pasuria e shtetit, Gjykata e sheh me vend të ndalet vetëm në trajtimin e këtij aspekti.

37. Ndalimi i ushtrimit të aktivitetit privat për deputetin në përgjithësi nuk është absolut. Një pjesë e legjislacioneve europiane e lejojnë një gjë të tillë me disa kufizime. Lejimi i mëtejshëm i ushtrimit të profesionit bazë të deputetit bazohet në parimin se deputeti nuk duhet patjetër të shkëputet tërësisht nga tregu i punës apo t'i hiqet mundësia për të ushtruar profesionin primar vetëm se ai merr përsipër të përfaqësojë interesat e popullit në organe përfaqësuese. Nga ana tjetër, ndalimi i ushtrimit të profesionit bazohet tek fakti që funksioni i deputetit është punë me kohë të plotë dhe duhet trajtuar gjatë gjithë legjislaturës si e tillë. Është me interes të shqyrtohet jo vetëm elementi kohë por edhe elementi pagë/shpërblim. Funksioni i deputetit është funksion që paguhet në përputhje me nivelin e përgjithshëm ekonomiko-financiar të një vendi. Për këtë arsye, deputeti nuk duhet të kujdeset për të ardhurat e tij gjatë kohës që ushtron detyrën, me qëllim përmbushjen sa më mirë të funksionit për të cilin ai është zgjedhur[23]. Hapësira e ushtrimit të profesionit primar të deputetit para se të bëhej i tillë i është lënë në dorë ligjvënësit të çdo vendi. Kështu, p.sh ligjvënësi austriak ka parashikuar në parim moskryerjen e mëtejshme të profesionit pas zgjedhjes deputet në dhomën e ulët (Nationalrat). Parlamentarët janë të detyruar të deklarojnë ushtrimin e profesionit të tyre pranë komisionit të posaçëm për këtë qëllim. Komisioni vendos nëse do të lejojë apo jo ushtrimin e mëtejshëm të profesionit. Lejimi jepet vetëm në rastet kur ushtrimi i profesionit nuk pengon ushtrimin e funksionit të deputetit në mënyrë objektive dhe të pandikueshme nga profesioni. Nëse komisioni nuk lejon ushtrimin e mëtejshëm të profesionit, brenda 3 muajve nga marrja e vendimit për këtë qëllim, deputeti është i detyruar të heqë dorë prej tij[24.] Ligjvënësi *gjerman* parashikon vetëm papajtueshmëritë midis dy funksioneve publike. Ushtrimi i profesionit privat lejohet por ekziston detyrimi për deklarimin e të ardhurave nga aktiviteti fitimprurës[25].

38. Pavarësisht rregullimeve të ndryshme të legjislacioneve të huaja, neni 70/2 i Kushtetutës parashikon ndalim të ushtrimit të funksioneve të tjera nga deputeti. Ndërsa neni 70/3 konsideron të papajtueshme me funksionin e deputetit ushtrimin e "*veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri të këtyre*". Ndalimet e tjera parashikohen me ligje të posaçme. Nga këto dispozita rezulton se Kushtetuta jonë ia delegon ligjeve të posaçme rastet e papajtueshmërisë (neni 70/2). Ajo ka preferuar të vendosë ndalimin në rang kushtetues dhe ta cilësojë si të papajtueshëm me funksionin e deputetit ushtrimin e aktivitetit fitimprurës prej tij, kur të ardhurat nga ky aktivitet burojnë nga buxheti i shtetit. Ky ndalim është i shprehur qartë dhe pa ekuivok nga kushtetutbërësi, i cili ka pasur si qëllim eliminimin e plotë të mundësive për ta konsideruar funksionin e deputetit si një mundësi e mirë për të shtuar burimin e të ardhurave private nëpërmjet pozitës së favorshme që ka ai si anëtar i organit më të lartë përfaqësues.

39. Gjykata çmon se në thelbin e kësaj dispozite qëndron një nga parimet bazë të ushtrimit të funksioneve publike, sipas të cilit: një pagë/shpërblim për një detyrë/funksion. Edhe në rastet kur një funksionari i lejohet të mbajë dy detyra/funksione publike, ai përsëri ka të drejtë të marrë një pagë/shpërblim. Nëse deputeti përveç pagës që do të merrte si i tillë, do të mund të merrte dhe të ardhura të tjera nga buxheti i shtetit për shkak të profesionit të tij primar, atëherë ky parim do të cenohej. Kjo i shërben parimit të shërbimit sa më të mirë ndaj qytetarëve dhe në fund të fundit parimit të demokracisë, ku çdo funksionar publik duhet të ushtrojë me të gjitha forcat dhe energjitë e veta detyrën për të cilën është zgjedhur ose emëruar, detyrë të cilën ai e ka pranuar me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë. E kundërta mbart, natyrshëm, dyshime lidhur me besueshmërinë e publikut në cilësinë e përfaqësimit të tij.

---

[22] Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane nr.3902/2002.
[23] Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BverfGE, 4.7.2007.
[24] Neni 2/2 dhe 2/3 i Ligjit Austriak për Papajtueshmëritë e Deputetit.
[25] Neni 38 i Ligjit Themelor Gjerman, si dhe Rregullat e Sjelljes së Anëtarit të Bundestag-ut.

C. Lidhur me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit Ilir Beqja

40. Nisur nga argumentet e trajtuara më lart lidhur me çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se momenti i betimit të deputetit shënon datën e fillimit të ushtrimit të detyrës së tij si deputet dhe jo fillimin e mandatit të deputetit. Në bazë të nenit 71/1 të Kushtetutës, megjithëse Ilir Beqja ka bërë betimin si deputet në datën 25.2.2010, mandati i tij parlamentar konsiderohet i fituar në momentin e shpalljes deputet nga KQZ-ja, pra në datën 1.8.2009, dhe jo ditën e betimit. Duke shqyrtuar në tërësi faktet dhe rrethanat e çështjes, Gjykata çmon se deputeti Ilir Beqja ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar nga neni 70/3 i Kushtetutës, kur ka marrë pjesë në tenderin e organizuar nga Bashkia Durrës dhe ka lidhur kontratë me përfaqësuesit e saj për informatizimin e mjediseve të asaj Bashkie, pasi atij i kishte filluar mandati i deputetit.

41. Deputeti Ilir Beqja kishte detyrimin që në momentin e shpalljes së tij fitues nga KQZ-ja të shmangte çdo rast të papajtueshmërisë. Pretendimi i tij kryesor se ai në atë periudhë nuk ishte deputet, pasi nuk kishte bërë betimin, është i pabazuar. Së pari, mandati i tij ka filluar që në datën 1.8.2009, ndërsa të ardhurat nga Bashkia Durrës ai i ka marrë në datën 17.2.2010 dhe 21.5.2010. Së dyti, mosbërja e betimit nga ana e tij nuk mund të paraqitet si shkak i ligjshëm, pasi ky veprim ishte rezultat i vendimmarrjes personale të tij bazuar mbi motive politike të bëra publike pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Fakti që ai nuk bëri betimin për disa muaj pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nga KQZ dhe fillimit të mandatit të deputetit nuk e përjashton atë nga përgjegjësia për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga mandati parlamentar, të filluar prej muajsh.

42. Gjykata rithekson se një deputet, i shpallur i tillë nga komisioni zgjedhor për të përfaqësuar vullnetin e popullit, nuk duhet ta lidhë marrjen e masave për ushtrimin e detyrës së tij në përputhje me kuadrin kushtetues ose ligjor me zhvillimet e rastësishme politike qofshin këto të lidhura direkt me interesat e grupimit politik ku ai bën pjesë. Deputeti ka përgjegjësi individuale për ushtrimin e detyrës së tij dhe nuk mund të justifikojë veprimet e tij jokushtetuese me situata të tjera jokushtetuese. Mosbërja e betimit pa arsye të përligjura përbën në vetvete cenim të nenit 72 të Kushtetutës dhe për këtë shkak duhet të ishte shmangur me kohë nga subjekti i interesuar dhe jo të përdoret si justifikim për situatën e papajtueshmërisë në të cilën ai ndodhej. Betimi është moment i rëndësishëm për konstituimin e Kuvendit dhe si i tillë nuk mund të trajtohet si vijë ndarëse kohore midis sjelljes kushtetuese dhe asaj jokushtetuese. Deputeti ka detyrimin që në momentin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, pavarësisht se kur bën betimin, të sillet si deputet. Një gjë e tillë nuk ka ndodhur në rastin e deputetit Ilir Beqja.

Për sa më lart, Gjykata, bazuar në analizën në tërësi të dispozitave kushtetuese relevante, fakteve dhe rrethanave të çështjes, arrin në përfundimin se deputeti Ilir Beqja ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga neni 70/3 i Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 70/3, 70/4, 131 shkronja “e” të Kushtetutës, si dhe të neneve 66/3 dhe 67/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja.
- Dërgimin e vendimit Kuvendit të Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj,

Anëtarë kundër: Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Në çështjen me kërkues Kuvendin e Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) dhe me objekt "Konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit të z.Ilir Beqja", nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën dhe e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

Shumica në këtë çështje, pretendimin e subjektit të interesuar për pavlefshmërinë e vendimit nr.65, datë 21.10.2010 të Kuvendit, e ka çmuar të pabazuar, me argumentin se ky vendim është marrë sipas një procesi të rregullt votimi dhe me shumicën e kërkuar të votave, në përputhje me nenin 78 të Kushtetutës (neni 78) dhe vendimin interpretues të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) nr.29, datë 21.10.2009 (vendimi nr.29). Në ndryshim nga shumica, gjykoj se vendimi i mësipërm i Kuvendit është absolutisht i pavlefshëm, për arsye se nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, sipas Kushtetutës dhe vendimit nr.29 të Gjykatës. Fillimisht janë parashtruar argumentet mbi të cilat është arritur në përfundimin se shumica, në vlerësimin e pretendimit të mësipërm të subjektit të interesuar, nuk është mbështetur në kuptimin normativ të nenit 78 të Kushtetutës, të interpretuar nga Gjykata me vendimin nr.29. Në vijim, bazuar mbi standardet e këtij të fundit, janë vlerësuar faktet e çështjes konkrete dhe është shtjelluar pse, në vlerësimin tim, vendimi i mësipërm i Kuvendit nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimin nr.29 të Gjykatës.

Organi ligjvënës, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, është subjekt i kufizimeve të përcaktuara në Kushtetutë. Këto kufizime, të cilat janë në funksion të konstitucionalizmit dhe shtetit të së drejtës, mund të jenë të karakterit procedural ose substancial. Rregullimet kushtetuese, për procedurat vendimmarrëse të Kuvendit dhe për shumicat e votave të kërkuara, i shërbejnë veçanërisht këtij qëllimi. Është detyrë e Gjykatës të garantojë respektimin e këtyre kufizimeve nëpërmjet interpretimeve të qarta, koherente dhe të qëndrueshme.

Parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton, midis të tjerave, edhe rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se, në aspektin kushtetues, është e palejueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra-tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve, të rregulluara në Kushtetutë. Kushtetuta, në nenet 124, 132 dhe 145/2, shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat (shih vendimin nr.21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, është e pranueshme, në mënyrë të natyrshme, që jurisprudenca kushtetuese të evoluojë, duke synuar rritjen e standardeve kushtetuese. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës Kushtetuese ose korrigjimi i doktrinës zyrtare kushtetuese mund të bëhet vetëm për arsye të rëndësishme, sidomos për ta harmonizuar atë me praktikën e GJEDNJ-së (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.21, datë 29.4.2010; nr.30, datë 17.6.2010; nr.20, datë 1.6.2011*). Edhe GJEDNJ-ja, në këtë këndvështrim, është shprehur se "Roli i një gjykate të lartë në një palë kontraktuese është pikërisht zgjidhja e konflikteve, shmangia e divergjencave dhe qëndrueshmëria." (*shih Çështja Mullai dhe të tjerët kundër Shqipërisë, datë 23.3.2010, paragrafi 83*).

Me vendimin nr.29, Gjykata ka pasur për objekt interpretimin e nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: "*Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar*". Në përfundim të analizës, kjo Gjykatë ka arritur në këtë interpretim autoritar dhe të detyrueshëm: *"…pika 1 e nenit 78 të Kushtetutës, në të cilin përcaktohet se "Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij" duhet interpretuar si vijon*:

1. Numri i deputetëve të pranishëm për çeljen e seancës së votimit parlamentar është minimalisht 71 deputetë.

2. Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm."

Përmbajtja normative e nenit 78, sipas konkluzionit të Gjykatës, mbështetet në interpretimet literale dhe teleologjike të dy elementeve kushtetues bazë të kësaj dispozite: "numri i kërkuar i deputetëve të pranishëm në momentin e votimit" dhe "shumica e votave të kërkuara që vendimi të konsiderohet i miratuar". Elementi i parë identifikohet në praktikat parlamentare të organeve kolegjiale të zgjedhura me konceptin "kuorum". Në vendimin e mësipërm, Gjykata, në funksion të interpretimit të nenit 78, ka dhënë këtë përkufizim për "kuorumin*":"Numri minimal i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm dhe që autorizohen për të vepruar në emër të organit quhet kuorum (përveç rastit kur një numri më të vogël i është dhënë kompetenca nga vetë organi ose kur një numër më i madh kërkohet veçanërisht). Kuorumi vendoset për të përcaktuar numrin minimal ose përqindjen e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm në çdo vendimmarrje të organit dhe që kanë autoritetin (autorizohen), për të marrë vendim në emër të të gjithë anëtarëve*." Gjithashtu, po në këtë linjë arsyetimi, Gjykata shprehet: *"…Numri i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm për zhvillimin e procedurave të vendimmarrjes, është të paktën gjysma plus një e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, minimalisht 71 deputetë (kuorumi). Prania e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, në çdo seancë vendimmarrje, është absolutisht e nevojshme për vlefshmërinë e vendimeve që merr ky organ, sipas përcaktimeve të nenit 78/1 të Kushtetutës. Numri i deputetëve të pranishëm për marrjen e vendimeve të Kuvendit mund të variojë nga 71 deri në 140 deputetë."* Në dallim nga kuptimi dhe interpretimi i mësipërm i Gjykatës në vendimin nr.29, shumica në këtë çështje shprehet se *"…Për përcaktimin e kuorumit në një proces votimi duhet t'i referohemi vetëm numrit të deputetëve që kanë votuar dhe jo numrit të përgjithshëm të deputetëve që ndodhen në sallë dhe që nuk votojnë."*

Ky interpretim është qartazi i ndryshëm nga ai i mbajtur nga Gjykata në vendimin nr.29. Në këtë të fundit, siç u trajtua dhe më sipër, në asnjë paragraf nuk jepet një kuptim i tillë i kurorumit, nuk përcaktohet se kuorumi do të llogaritet jo mbi numrin e deputetëve të pranishëm, por mbi deputetët që kanë marrë pjesë në votim.

Interpretimi në të cilin ka arritur Gjykata me vendimin nr.29, mbështetet në tre premisa kryesore që janë: a) nëse norma lë hapësirë për dy interpretime duhet të përzgjidhet interpretimi që siguron një bazë më të gjerë legjitimiteti; b) pjesëmarrja e deputetit në procesin vendimmarrës në seancat plenare të Kuvendit, nuk përbën vetëm një të drejtë të tij, por njëkohësisht, dhe një detyrim që rrjedh nga roli i tij si përfaqësues i popullit; c) interpretimi duhet të jetë i qartë, koherent dhe të krijojë siguri në zbatimin në praktikë. Në vijim, këto argumente trajtohen më hollësisht duke evidentuar njëkohësisht dhe dallimet me linjën e arsyetimit të ndjekur nga shumica në çështjen objekt i këtij mendimi pakice.

Gjykata, në vendimin nr.29, shprehet se prania e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit në marrjen e vendimeve, është parashikuar: *së pari*, për të siguruar legjitimitetin e vendimmarrjes së Kuvendit, pasi duke pasur një numër më të madh të deputetëve që marrin pjesë aktive, vendimi që merret mbështetet në një bazë më të qëndrueshme; dhe *së dyti*, për të siguruar një vendimmarrje sa më cilësore dhe racionale, duke qenë se është marrë nga një bazë më e gjerë deputetësh të pranishëm. Për sa i përket lidhjes midis kuorumit të të pranishmëve dhe kuorumit të votimit (siç është referuar nga shumica më poshtë), Gjykata, në vendimin nr.29, ka nënvizuar se "*numri i anëtarëve të pranishëm verifikohet për efekt të vlefshmërisë së vendimit dhe për të llogaritur rezultatin përfundimtar, që do të thotë se prania e deputetëve, në çdo rast, përcakton shumicën e votave që duhen për marrjen e vendimit të Kuvendit"*. Ndryshe nga arsyetimi i mësipërm, shumica në këtë çështje argumenton se *"…një deputet që nuk shpreh vullnet me votën e tij dhe si rrjedhojë nuk ndikon në procesin e votimit në Kuvend, nuk duhet të llogaritet në konceptin "shumicë e të pranishmëve" për efekt të kuorumit të votimit. Nëse do të pranonim të kundërtën, atëherë do të prodhohej një rritje artificiale dhe e pajustifikuar e kuorumit, gjë e cila nuk është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit."* Shumica i është referuar qëndrimit të konsoliduar të Gjykatës në vendimin nr.29, por duke i dhënë një tjetër kuptim.

Interpretimi i shumicës, duke konsideruar për efekt të arritjes së kuorumit të votimit jo të pranishmit por numrin e deputetëve që kanë marrë pjesë në votim, sjell për pasojë zvogëlimin e shumicës së votave të kërkuara në përpjesëtim me mospjesëmarrjen e deputetëve në votim, dhe për rrjedhojë kjo e dobëson legjitimitetin e vendimmarrjes së Kuvendit. Për më tepër, një interpretim i tillë mund të krijojë praktikë të gabuar për procedurat e ardhshme të votimit në Kuvend.

Argumenti tjetër i rëndësishëm, mbi të cilën mbështetet Gjykata në vendimin interpretues nr.29, është pohimi se "*pjesëmarrja e deputetit në procesin vendimmarrës në seancat plenare të Kuvendit, nuk përbën vetëm një të drejtë të tij, por njëkohësisht, dhe një detyrim që rrjedh nga roli i tij si përfaqësues*". Edhe ky argument i Gjykatës është në funksion të interpretimit përfundimtar të nenit 78 të Kushtetutës.

Gjykata, duke konkluduar se "*vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm*", niset nga prezumimi se deputetët që janë deklaruar të pranishëm kanë shprehur vullnetin për të marrë pjesë në votim dhe duhet ta shprehin këtë vullnet në një nga mënyrat e votimit, sipas Rregullores së Kuvendit. Përmbushja e këtij detyrimi të deputetëve për të marrë pjesë në vendimmarrje, përfshihet në sferën e kompetencës së Kuvendit, dhe mund të realizohet nëpërmjet Rregullores së Kuvendit.

Në radhë të parë, neni 78 i Kushtetutës, sipas interpretimit autoritar të Gjykatës, imponon Kuvendin që të rregullojë procedurat e votimit, për të qenë në harmoni me konceptin e detyrimit të deputetit për të marrë pjesë në votim. Pra, procedura duhet të jetë e tillë që deputetit, i cili deklarohet i pranishëm por nuk voton, t'i kërkohet të votojë dhe nëse ai nuk pranon, të ketë dhe "sanksione" sipas praktikave parlamentare. Së dyti, duhet të parashikohet një angazhim aktiv i drejtuesit të seancës për të verifikuar mospjesëmarrjen në votim të të pranishmëve dhe për t'ju kërkuar këtyre të fundit të marrin pjesë në votim. Rregullimi i procedurave të votimit në këtë drejtim duhet të kihet parasysh edhe për të shmangur një lloj obstruksionizmi parlamentar, që mund të krijohet në praktikë. Logjikisht, nëse deputeti është i pranishëm dhe nuk merr pjesë në votim, duke ndikuar kësisoj në kuorumin vendimmarrës, nuk mund të "shpërblehet" për moskryerjen e detyrës së tij, për të cilën është zgjedhur.

Duke iu referuar kuptimit të abstenimit, si një shprehje e vullnetit për të mos votuar as "pro" as "kundër", për analogji, mund të themi se, nëse deputeti është i pranishëm, por nuk e shpreh vullnetin për të votuar "pro" ose "kundër", kjo indiferencë e tij mund të konsiderohet si abstenim. Nisur nga fakti që abstenimi llogaritet për të përcaktuar kuorumin e votimit dhe duke pasur parasysh detyrimin e deputetëve për të votuar, interpretimi që dekurajon mospjesëmarrjen në votim është pikërisht interpretimi që e konsideron këtë mospjesëmarrje si abstenim. E parë në prizmin e një lloj "sanksioni", kjo do të nxiste pjesëmarrjen e deputetëve në votim dhe do t'i jepte një legjitimitet më të madh si procesit të votimit ashtu edhe aktit përfundimtar.

Argumenti i tretë lidhet me qartësinë, sigurinë dhe koherencën që duhet të realizohet nëpërmjet interpretimit kushtetues. Siç u përmend dhe më sipër, Gjykata në vendimin nr.29 ka arritur në konkluzionin se "*Vendimi i Kuvendit miratohet kur për të kanë votuar pro jo më pak se gjysma plus një e anëtarëve që janë të pranishëm.*" Ky interpretim, përveç të tjerave, krijon qartësi dhe siguri në praktikë. Mbasi është verifikuar prezenca, përllogaritja e shumicës së kërkuar të votave, për t'u konsideruar një vendim i miratuar, vlerësohet lehtësisht: gjysma plus një e deputetëve që janë të pranishëm. Në këtë vendim, ndër të tjera, Gjykata shprehet se "*Numri i anëtarëve të pranishëm verifikohet për efekt të vlefshmërisë së vendimit dhe për të llogaritur rezultatin përfundimtar, që do të thotë, se prania e deputetëve, në çdo rast, përcakton shumicën e votave që duhen për marrjen e vendimit të Kuvendit. Rregulli i mësipërm duhet kuptuar se, kur në seancën për marrjen e vendimit janë të pranishëm 71 deputetë, vendimi konsiderohet i miratuar kur për të kanë votuar pro jo më pak se 36 deputetë. Çdo rritje e numrit të të pranishmëve, domosdoshmërish shoqërohet me rritje të numrit të nevojshëm të votave pro për miratimin e vendimit."* Pra është e qartë, që Gjykata, në rastin e supozuar, vendimin e konsideron të miratuar kur kanë votuar "pro" jo më pak se 36 deputetë, nëse kanë qenë të pranishëm 71 deputetë, pavarësisht nga pjesëmarrësit në votim. Interpretimi i shumicës, ndryshe nga ai i vendimit të mësipërm, krijon hapësirë për keqkuptime dhe paqartësi gjatë zbatimit në praktikë. Kështu, shumica shprehet se "në rastin konkret, është votuar fillimisht për praninë e deputetëve në sallë me qëllim përcaktimin e kuorumit të domosdoshëm për votimin e kërkesës së grupit të deputetëve". Sipas Rregullores së Kuvendit (neni 56) drejtuesi i seancës plenare, përpara çdo votimi, verifikon numrin e deputetëve të pranishëm në sallë. Është e qartë se nuk votohet për prezencën, por ajo verifikohet nga drejtuesi i seancës. Gjithashtu, ky qëndrim i shumicës mund të krijojë ekuivoke, pasi mund të interpretohet në sensin që Kuvendi kalon në proces votimi pa qenë i sigurt se ekziston kuorumi i nevojshëm i pranisë së deputetëve në seancë. Në nenin 55 të Rregullores së Kuvendit përcaktohet se: "*Ligjet, vendimet, deklaratat dhe rezolutat konsiderohen të miratuara nga Kuvendi kur për to kanë votuar pro shumica e deputetëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit, me përjashtim të rasteve kur në Kushtetutë parashikohet shumicë e cilësuar për miratimin e tyre"*. Ky rregullim përmban të njëjtin formulim që parashikohet në nenin 78/1 të Kushtetutës. Termi "*në prani*", i cili reflektohet si në nenin 78 të Kushtetutës, ashtu edhe në nenin 55 të Rregullores së Kuvendit, përbën një koncept kushtetues dhe, si i tillë, duhet t'i jepet një kuptim i caktuar dhe i qartë për të shmangur interpretimet jokoherente dhe kontradiktore.

Në çështjen konkrete, sipas tabulateve të nxjerra nga administrata e Kuvendit, në seancën e datës 21.10.2010, në momentin e votimit të kërkesës së një grupi deputetësh për të dërguar në Gjykatën Kushtetuese çështjen e konstatimit të papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të z.Ilir Beqja, kanë qenë prezent në sallë 140 deputetë, kanë marrë pjesë në votim 139, nga të cilët: 70 kanë votuar "pro", 67 "kundër" dhe 2 "abstenim". Nisur nga interpretimi i Gjykatës në vendimin nr.29, vendimi i Kuvendit i marrë në këtë seancë konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, sepse nuk ka marrë numrin e nevojshëm të votave, që përllogaritet me gjysmën plus një të anëtarëve të pranishëm, që do të thotë minimumi 71 vota "pro". Në ndryshim nga kjo linjë interpretimi, shumica e konsideron vendimin e Kuvendit të vlefshëm duke u nisur jo nga numri i deputetëve të pranishëm, por nga numri i deputetëve që kanë marrë pjesë në votim, që në rastin konkret është 139.

Nisur nga sa më sipër, gjykoj se pretendimi i subjektit të interesuar për pavlefshmërinë e vendimit nr.65, datë 21.10.2010 të Kuvendit, është i bazuar, për arsye se ky vendim është marrë jo sipas një procesi të rregullt votimi dhe jo me shumicën e kërkuar të votave, sipas nenit 78 të Kushtetutës dhe vendimit interpretues të Gjykatës nr.29.

Anëtar: Sokol Berberi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 7.10.2011
Doli nga shtypi më 7.10.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 28 lekë